



100

Organizata Anëtare

€11,909

Grante & Paisje për Anëtarët

29+

Vullnetare

967

Pëlqime në Facebook

Raporti Vjetor 2012

87

Letra Avokuese

920,428

Klikime në Ueb-faqe

Gjatë Vitit 2012

8 Grupe Avokuese për Barazi Gjinore

78

**Përfshirje në
Media**

442,335

Përcollën Aktivitetet Tona në Facebook

PËRMBAJTJA

Ridefinimi i fuqisë, lirisë dhe të drejtës: Letër nga Bordi Kryesues i RrGGK.....	4
Hyrje	6
Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës	6
Strategjia.....	6
Raporti vjetor.....	7
Ngritja e Kapaciteteve të RrGGK-së.....	8
Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Politikë dhe Vendimmarrje.....	31
Përmirësimi i Qasjes së Grave në Kujdesin Cilësor Shëndetësor	43
Një Jetë e Lirë nga Dhuna në Familje dhe Trafikimi.....	46
Avansimi i Fuqizimit Ekonomik të Grave.....	49
për më Tepër... ..	51
Fillimi i iniciativës së rrëfimeve gojore.....	51
Mbulimi mediatik dhe aktivizmi në internet.....	52
Vlerësimi i Punës së RrGGK	54
Mbështetësit e rrjetit dhe Mbështetja për Anëtarët.....	56
Mbështetësit tanë	56



Raporti financiar i RrGGK-së për vitin 2012.....	57
Duke i Mbështetur anëtarët: Grantet e Fondit të Grave të Kosovës	60
Donacionet për anëtarët e RrGGK-së	61
Për Ne.....	62
Bordi këshilldhënës i RrGGK-së.....	62
Bordi i drejtoreshave të RrGGK-së.....	62
Anëtarët e stafit të RrGGK-së në 2012.....	62
Stafi kohë-shkurtër dhe ekspertet	63
Praktikantët e RrGGK-së dhe vullnetarët.....	63
Anëtarët e RrGGK-së.....	64



Me 8 Mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, RrGGK mobilizoi qytetarët të kërkojnë drejtësi për gratë që kanë mbijetuar dhunën seksuale gjatë luftës.



RIDEFINIMI I FUQISË, LIRISË DHE TË DREJTËS: LETËR NGA BORDI KRYESUES I RRGKK

Të nderuara anëtare të Rrjetit,

Është bërë zakon që në letra dhe adresime të tilla të shkruhet për rezultatet e një organizate apo edhe të shoqërisë. Për mua është kënaqësi të ju adresohem me këtë letër në këtë raport vjetor, e kjo nuk është asgjë më shumë se një reflektim, pas dy viteve shërbimi si kryesuese e bordit të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, për të treguar se ku jemi dhe ku ishte dashur të ishim.

Për të shërbyer në një pozitë të tillë duhet bërë luftë me veten e në të njëjtën kohë edhe me shoqërinë. Shpesh gjejmë veten duke mbrojtur veprimet tona, e duke gjetur kompromis rreth mënyrave të veprimit. Kjo ndodh sepse e shohim veten të kufizuar në fushën ku veprojmë. Mos po e kalojmë kufirin e civiles dhe po bëhemi politike? Nëse nuk na “takon” neve të kërkojmë diçka sepse ato i takojnë domenit tjetër, e që zakonisht është e udhëhequr nga burrat? Nëse një formë e veprimit është ‘privatizuar’ e tash nuk kemi mundësi ta bëjmë të njëjtën?



Elmaze Gashi, nga Bordi Kryesues i RrGGK, Prezanton në Komisionin e 57 të Kombeve të Bashkuara mbi Statusin e Gruas në Mars të vitit 2012 mbi “Shqetësimet e Grave Rurale: Çfarë ka të bëjë gjinia, klasa dhe raca me këtë?”.



Lëvizja e grave ka filluar me protesta për të drejta elementare të grave, e që në fakt janë të drejtat elementare të njeriut: për përfshije në sferën publike. Vala e tretë e feminizmit zhvillohet rreth konceptit të asaj se “personalja është politike”. Politike rrjedhimisht është secili veprim që e ndërmarrim. Si qenie njerëzore jemi politike. Po ta mohosh këtë është si të mos ekzistosh.

Të qenit “politike” nuk është keq, derisa kjo bëhet brenda parimeve të përcaktuara me mision të Rrjetit dhe besimeve që ne i ndajmë. Të bërit “politike” e një çështjeje, ka të bëjë me vendosjen e saj në domenin publik, ku ajo që konsiderohet private i nënshtrohet debatit publik dhe përmes kritikës kërkohen zgjidhje adekuate brenda sistemit ligjor të shtetit.

Problemet me “mundësitë e barabarta mes gjinive” kanë filluar të gjejnë zgjidhje në momentin kur raporti burrë – grua zhvendoset në hapësirën publike – pra politizohet. Sepse për aq sa ajo qëndron e papolitizuar, dominimi gjinor është i pakontestueshëm. Nuk ka asgjë të keqe në të bërit “politike” të një çështjeje, sepse politika është loja përmes së cilës një shoqëri i përcakton vlerat dhe kahjet e veta të zhvillimit dhe emancipimit.

Është e nevojshme të ridefinohen marrëdhëniet e fuqisë në një shoqëri patriarkale dhe ridefinimi i marrëdhënieve të fuqisë nuk mund të bëhet brenda grupit/sojit. Duhet të dalim përtej vetes, bile edhe ta tradhetojmë veten, që të mund të shohim çka na rrethon dhe çka duhet të konsiderojmë si të drejtë dhe të rëndësishme.

Ishte kënaqësi dhe nder për mua që isha pjesë e arritjeve që keni shënuar.

Sinqerisht,
Elmaze Gashi



HYRJE

Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës

Misioni i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, moshë, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RrGGK e realizon këtë mision përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve.

Strategjia

Në drejtim të arritjes së misionit tonë, kemi përpiluar një Plan Strategjik për vitet 2011-2014. Qëllimi i kësaj strategjie është që të udhëzojë punën e RrGGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar me kontributin e anëtareve të RrGGK-së, Bordi i Drejtoreshave, dhe partnerë të tjerë si dhe palët e interesuara. Strategjia e RrGGK-së fokusohet në pesë fusha programore: I) Ngritja e kapaciteteve të RrGGK-së; II) Gratë në politikë dhe vendim-marrje; III) Shëndeti i grave dhe vajzave; IV) Dhuna në familje dhe trafikimi; dhe V) Fuqizimi ekonomik i grave. Këto fusha veprimi u identifikuan nga anëtarët e RrGGK-së si shumë të rëndësishme ku RrGGK-ja duhet të përqendrohet në vitet e ardhshme.



Anëtarët e RrGGK-së krijojnë strategji për përfshirje më të madhe të vajzave në aktivitetet e RrGGK-së.



Raporti vjetor

Çdo vit ne u raportojmë anëtareve, partnerëve dhe miqëve tanë për përparimin që kemi bërë drejt arritjes së qëllimeve tona strategjike. Ky raport është i ndarë në pesë pjesë, ku secila prej tyre përfshin një nga qëllimet tona strategjike afatgjate:

- I) Ngritja e kapaciteteve të RrGGK-së;
- II) Gratë në politikë dhe vendim-marrje;
- III) Shëndeti i grave dhe vajzave;
- IV) Dhuna në familje dhe trafikimi; dhe
- V) Fuqizimi ekonomik i grave.

“RrGGK është një motor i lëvizjes së grave në Kosovë. Ne duhet të punojmë vazhdimisht së bashku për kauzën e grave.”
- Belgjyzare Muharremi, OJQ Dera e Hapur

Në këtë raport prezantojmë progresin dhe rezultatet e arritura në vitin 2012, duke përfshirë aktivitetet kryesore që u zhvilluan në arritjen e këtyre rezultateve. Anëtarët dhe bashkëpunëtorët tanë mund të vënë re se disa nga aktivitetet e

vitit 2012 janë duke vazhduar gjatë kohës së këtij raportimi. Raporti gjithashtu përmban informata të dobishme rreth buxhetit, mbështetësve financiar, bordit të drejtoreve, bordit këshillëdhënës, stafit, praktikanteve, vullnetareve dhe anëtareve tona.



Anëtarët dhe bashkëpunëtorët e RrGGK-së marrin pjesë në “Punëtorinë e Qëndrueshmërisë për Gratë Aktivistë në Kosovë” në Durrës, Shqipëri.



NGRITJA E KAPACITETEVE TË RRGK-SË

Programi i ngritjes së kapaciteteve si qëllim kryesor ka që grupet dhe organizatat e grave në Kosovë, rajon dhe në nivel ndërkombëtar të kenë bashkëpunim dhe komunikim të rregullt, si dhe të organizohen rreth çështjeve me interes të përbashkët. Në vitin 2013 kemi bërë progres të madh drejt arritjes së këtij qëllimi:

- Sigurimi i komunikimit dhe bashkëpunimit të rregullt mes anëtareve të RrGGK-së dhe palëve tjera;
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të RrGGK-së dhe anëtareve të saj drejt ngritjes së kapacitetit për avokim dhe qëndrueshmërisë afat-gjate të Rrjetit; dhe
- Rritja e bashkëpunimit mes grave në rajon në temat e paqes, drejtësisë tranzicionale dhe sigurisë.

Gjatë vitit 2012, RrGGK ka arritur rezultate të cilat kontribuan në arritjen e këtyre qëllimeve, ashtu siç janë planifikuar në planin strategjik.

Anëtarët e RrGGK-së të informuara rreth nismave të anëtareve tjera, aktiviteteve të RrGGK-së, mundësive të financimit, si dhe për informata tjera

Ndarja e informatave është bërë kryesisht përmes takimeve të rregullta RrGGK-së (tetë takime të cilat u realizuan gjatë vitit 2012): më 27 shkurt në Prishtinë (70 pjesëmarrëse); më 2 prill Kvinna till Kvinna (KtK) ka publikuar publikimin “Krijo Hapsirë për Paqe” në Prishtinë (58); më 28-29 prill në Prevallë (34); më 7-8 korrik në Prevallë (42); më 16 korrik në Prishtinë (35); më 3 shtator në Prishtinë (50); më 12-14 tetor në Durrës (79); dhe më 5 nëntor në Mitrovicë (60). Gjatë takimeve, anëtarët shkëmbyen informata; u informuan rreth aktiviteteve të RrGGK-së si dhe për aktivitetet e njëra-tjetrës; poashtu bashkëpunuan që të përpilohen kriteret për Fondin e Grave të Kosovës. Gjatë takimit



në Prevallë në muajin korrik, anëtarët e RrGGK diskutuan rreth “Qëndrueshmërisë së Rrjetit: Çfarë mund t’i ofrojnë anëtarët RrGGK-së?” Anëtarët identifikuan mënyrat dhe aftësitë që ato kanë për të ndihmuar njëra-tjetrën. RrGGK ka krijuar një bazë të të dhënave me këto informata, që është duke qarkulluar mes anëtareve në mënyrë që ato të mund të ndihmojnë njëra-tjetrën. Këto raste të rëndësishme të rrjetizimit të RrGGK-së janë mbështetur nga KtK.

“Falemnderit RrGGK që na sollët së bashku në Durrës. Kur veprojmë bashkë, jemi më të fuqishme”.
- Ola Syla, OJQ Drita e Krushës

Rreth 160 pjesëmarrëse ishin prezente në kuvendin e 10-të vjetor të anëtareve të Rrjetit të Grupeve të Grave (RrGGK) më 15 dhjetor në Prishtinë, duke shënuar kështu kuvendin vjetor me pjesëmarrjen më të madhe që nga themelimi i RrGGK-së. Pjesëmarrëset ishin përfaqësuese të organizatave anëtare të RrGGK-së, partnerët, donatorët dhe media.

Takimi filloi me Korin e Grave “Lira”, organizatë anëtare e RrGGK-së, si dhe me një poezi kushtuar gruas të shkruar dhe recituar nga aktorja dhe aktivistja Safete Rogova. Pastaj, kryetarja e Bordit të RrGGK-së, Elmaze Gashi hapi mbledhjen. Ajo lexoi letrën e botuar në Raportin Vjetor të RrGGK-së, e cila reflekton përparimin e RrGGK-së gjatë vitit 2012. Ajo theksoi se pasi që personalja është politike, lufta për arritjen e të drejtave të grave është dhe ka qenë gjithmonë politike, prandaj puna e RrGGK-së është dhe duhet të jetë poashtu edhe politike.

“Arsyeja se pse jemi këtu është për të ndihmuar organizatat e grave të bëhen më të qëndrueshme dhe më të forta në komunitetin në të cilat ato veprojnë”, tha Lina Andeer, përfaqësuese e Kvinna till Kvinna (KtK) partnere dhe përkrahëse e



Anëtarja e RrGGK Stanica Kovacevic falënderon RrGGK-në për punën e bërë në vitin 2012.



RrGGK-së. Për këtë qëllim, KtK ka mbështetur themelimin e Fondit të Grave të Kosovës të RrGGK-së. Ky fond u mundëson organizatave që të kenë qasje në grante të vogla, duke mbështetur punën e tyre të vështirë për forcimin e pozitës së gruas në shoqëri.

Përveç mbështetjes së vazhdueshme të KtK-së për Fondin e Grave të Kosovës, RrGGK kishte kënaqësinë të mirëpres Christian Geosits, përfaqësues i Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), i cili njoftoi fillimin zyrtar për mbështetjen e tyre dy-vjeçare për RrGGK-në.



Kuvendi i vjetor kishte përkthim në gjuhën e shenjave, serbisht, shqip dhe anglisht.

“Jam shumë i kënaqur të bashkëpunoj me ju për të mbledhur fonde për gratë në Kosovë”, tha ai. ADA do të financojë 80.000€ në grante për anëtarët e RrGGK-së gjatë viteve 2013-2014, poashtu edhe për Grupet Avokuese për Barazi Gjinore të mbështetura nga RrGGK në 13 komunat e Kosovës.

Drejtoresha ekzekutive, Igballe Rogova, raportoi për punën e RrGGK-së gjatë vitit 2012 si dhe për prioritetet për vitin 2013. Anëtarët e RrGGK-së patën mundësinë që të flasin për punën e RrGGK-së si dhe shkëmbyen informata në lidhje me aktivitetet e tyre gjatë vitit 2012.

“Dua të falenderoj stafin e RrGGK-së për mbështetjen që na kanë dhënë në fusha të ndryshme”, tha Bajramshahe Jetullahu nga Komiteti i Grave të Verbëra, “duke përfshirë seminarin e fundit mbi shkrimin e propozimeve të projektit si dhe ndihma të tjera që RrGGK dhe Igballe Rogova si udhëheqëse e saj kanë dhënë shumë për ne në



mënyrë që të përmirësohet gjendja dhe pozita e grave të verbëra në Kosovë.” Ajo pastaj i dha Igballe Rogovës një Mirënjohje.

Pas drekës, këngëtarja e njohur kosovare Rona Nishliu përformoi këngën e re, “Se vetëm zemra flet saktë”. Ajo e kompozoi këtë këngë për fushatën kundër dhunës “Bonu cool, mos bjer shpullë!”, të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Multimedia dhe Iniciativa e Rinisë për të Drejtat e Njeriut.

Pas performancës, Rona ishte e para që zgjodhi një numër për lojën shpërblyese të RrGGK-së, gjatë të cilës RrGGK ndau çmime për anëtarët e saj. Anëtarët që fituan në lojën shpërblyese ishin:

- Sadije Dulahu nga OJQ Lulishtja: një kompjuter tavoline
- Gjylfidane Morina nga OJQ Ne jemi pjesë të botës: një laptop
- Advije Gashi nga OJQ Norma: një telefon mobil
- Valire Buza nga OJQ Lira: dy CD
- Hasime Tahiri nga OJQ Mundësia: një maus për kompjuter
- Ola Sylja nga OJQ Drita e Krushës: një USB
- Mimoza Paçuku nga Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë: një USB.
- Atifete Aziri nga Legjenda: një termometër elektronik.



*Këngëtarja Rona Nishliu
ndihmon me shpërblimet për
anëtarët e RrGGK.*

RrGGK ndau mirënjohje për tri aktivistet e shquara nga rajoni: Delina Fico nga Shqipëria, për frymëzimin dhe mbështetjen e vazhdueshme dhënë Rrjetit; Lepa Mlladenoviç nga Serbia si motër feministe përtej kufijve dhe Dr. Zylfije Gjoni Duraku, Drejtoreshë e organizatës Anima nga Ulqini, Mali i Zi për punën e saj si aktiviste për të drejtat e grave dhe vajzave. Së fundi, anëtarët e RrGGK-së zgjodhën katër anëtare të reja të Bordit: Elmaze Gashi, Ariana Qosaj-Mustafa, Nermin Mahmutaj dhe Ola Syla. Në fund të ditës, anëtarët e RrGGK-së gjithashtu paraqitën vlerësimet e tyre për RrGGK-në dhe punën e saj në vitin 2012, së bashku me dy anketa për organizatat e tyre dhe hapat e ardhshëm respektivisht pas Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Takimi përfundoi me një tortë të madhe të dekoruar me fishekzjarre, duke festuar kështu 10 vjetorin e Kuvendit të Anëtareve të RrGGK-së. Anëtarët patën mundësi për rrjetizim, shkëmbyen dhe diskutuan për përvojat e tyre gjatë aktivitetëve.

Anëtarët e RrGGK-së dhe puna e tyre e dukshme për partnerët potencialë, gratë aktiviste në nivel ndërkombëtar dhe për mbështetësit e mundshëm

RrGGK gjatë vitit 2012 ka shpërndarë përmes e-postës dhe Facebook-ut informata në lidhje me punën e anëtareve të RrGGK-së, më shumë se 15 herë. RrGGK gjithashtu shkroi artikuj për punën e anëtareve të RrGGK-së në buletin tonë *Zëri i Grave Kosovare*, i cili dërgohet tek qindra njerëz rreth botës. Për shembull, kemi shpërndarë informatën rreth marshimit kundër kancerit të gjirit organizuar nga Jeta-Vita dhe panairit vjetor të artizanateve organizuar nga *Dera e Hapur*. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës të RrGGK-së, Femra Vizionare e shekullit XXI poashtu ka promovuar punën e organizatave lokale të grave në Prizren (për më shumë informata shih më poshtë).



Përveç kësaj, në vitin 2012 RrGGK vazhdoi përpjekjet për të prezantuar anëtarët e saj me partnerët potencial. Për shembull, kur Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore formoi një grup punues me bashkëpunëtorë të ndryshëm duke u fokusuar në çështjen e dhunës seksuale gjatë luftës, RrGGK ka insistuar që Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe Medica Kosova të përfshihen në këtë grup punues. Të dyja këto organizata anëtare të RrGGK-së kanë ekspertizë në këtë çështje. Këto organizata që nga ajo kohë i janë bashkangjitur këtij grupi punues. Në mënyrë të ngjashme, kur Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore organizoi aktivitetet për 15 ditë me radhë kundër dhunës ndaj grave, RrGGK ka prezantuar tek palët e interesuara organizatën anëtare, *Dora Dorës* që merret me këtë çështje në Prizren, e cila iu bashkangjiti fushatës. Gjatë Javës së Fushatës së Grave, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), kërkoi nga RrGGK të dhëna në lidhje me organizatat e grave që janë aktive dhe që mund të marrin pjesë, RrGGK sugjeroi 20 prej anëtareve të saj, shumë prej të cilave kanë vazhduar të jenë të përfshira në Programin e Liderit të Grave të NDI.

RrGGK do të punojnë më shumë në këtë fushë gjatë vitit 2013. Ne planifikojmë të bashkëpunojmë me përfitueset dhe anëtarët nga Fondi i Grave të Kosovës, duke ju ndihmuar që të zhvillojnë planet e kontaktimit me publikun në drejtim të përmirësimit të dukshmërisë së aktiviteteve të tyre.

Sa më shumë anëtare aq më shumë mundësi për të mbledhur fonde, për të planifikuar në mënyrë efektive, për të ndërmarrë nisma efektive avokuese

Gjatë takimit në Prevallë, anëtarët diskutuan për strategji të reja për financimin e organizatave të grave. Me detë e parashtruara gjatë atij takimi, RrGGK është duke përgatitur një broshurë me ide për mbledhjen e fondeve për anëtarët e saj. RrGGK gjithashtu diskutoi për “Donatorët e tanishëm dhe të ardhshëm në Kosovë: Ku janë paratë për të drejtat e grave?” si dhe rreth punës së saj në një dokument me të dhëna që do të përmbajë informata për donatorë të



ndryshëm si dhe programet e tyre. RrGGK i dërgoi anëtareve të saj informata në lidhje me grantet të ofruara nga Programi i USAID-it për Ndërmarrësit e Rinj, Komisioni Evropian, Agjencia Suedeze për Zhvillim, UN Women, UNDP si dhe Fondet e Mirëbesimit të OKB-së.

“Pjesa më e mirë është kur na humbë ndonjë takim, ju gjithmonë na informoni nëpërmjet e-postës dhe ueb-faqes tuaj për vendimet dhe çështjet e diskutuara.”
- Anëtare e RrGGK-së

Menaxhimit të Ciklik të Projektit, menaxhimit të bazuar në rezultate, Kornizës Logjike, Analizave të Palëve të Interesit. Temat përfshinin planifikimin dhe buxhetimin; raportimin; dhe kalkulimin e rrogave, duke përfshirë edhe zbritjen e tatimit në të ardhura me një program të ofruar për anëtarët e RrGGK-së që kullon rrogat. RrGGK ka distribuar pa pagesë këtë program për anëtarët. Punëtorja ka kontribuar në implementimin e Kodit të Mirësjelljes, që kërkon praktikata më të mira në menaxhimin financiar.

Përveç kësaj, anëtarët e stafit RrGGK-së ofruan mentorim në baza individuale ku 30 seanca konsultative u mbajtën me të paktën 13 organizata anëtare. RrGGK i ofroj anëtareve ndihmë pa pagesë me përkthime, shkruarjen e projekt propozimeve, buxhetim dhe menaxhim financiar.

Poashtu drejt ngritjes së kapaciteteve të anëtareve për mbledhjen e fondeve dhe planifikimin efektiv të projektit, duke u bazuar në nevojat e indentifikuara të anëtareve, RrGGK ka mbajtur dy trajnime nga dy ditë lidhur me shkruarjen e Projekt Propozimeve. Ekspertet brenda RrGGK-së i barten teknikat e

“Ju jeni shumë korrekt në punën tuaj dhe na ndihmoni shumë. Ne jemi gjithmonë të informuara me kohë për informata të dobishme.”
- Anëtare e RrGGK-së



RrGGK gjithashtu ofroi mbështetje me teknikat e avokimit për një numër të organizatave anëtare. Për shembull, RrGGK, në mesin e anëtareve të tjera, ka ofruar këshilla për Qendrën Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit “Jeta / Vita” rreth organizimit të marshimit tradicional “Ecje për shërim”, organizuar më 5 tetor; poashtu edhe Organizatës së Personave me Distrofi Muskulare për organizimin e ngjarjes së tyre publike në Prizren (shih më poshtë).

U themelua Fondi i Grave të Kosovës së RrGGK-së

Organizatave të grave në Kosovë ndërmarrin aktivitete të rëndësishme të avokimit për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar barazinë gjinore në nivel komunal. Disa organizata angazhohen për të rritur pjesëmarrjen e gruas në fushën politike. Mirëpo, organizatat e grave përballen me kufizime të shumta gjatë zbatimit të aktiviteteve të tyre. Mundësitë e kufizuara në fonde kanë qenë një çështje e rëndësishme që u ngrit nga organizatat anëtare të RrGGK-së. Zhvendosja e prioriteteve të përkrahjes dhe zvogëlimi i buxheteve kanë detyruar shumë donatorë në Kosovë që të mbyllin programet e tyre të granteve apo të zvogëlojnë fondet për organizatat joqeveritare (OJQ-të). Të tjerët kanë fonde në dispozicion, por kanë procedura të vështira për aplikim dhe/apo japin vetëm për grante të konsiderueshme (€50-100,000). Shkrimi i një projekt propozimi për të marrë fonde nga Komisioni Evropian, një nga donatorët kryesor, është si një “shkrim i temës për master”, aktivistet e të drejtave të grave ankohen për këtë çështje.

Kështu që, grupet e grave që kanë kufizime të burimeve njerëzore me orar të plotë dhe me mos shkathtësi të gjuhës angleze përballen me vështirësi në marrjen e fondeve për iniciativat e tyre të rëndësishme drejt barazisë gjinore dhe avacimit të të drejtave të grave. Kjo çështje iu është bërë me dije RrGGK-së nga organizatat anëtare.

Prandaj, RrGGK në konsultim të ngushtë me 100 anëtarët e saj vendosën të krijojnë një Fond të Grave të Kosovës.



Fondi, i mbështetur me zemërgjerësi nga KtK, ofron grante të vogla (deri në 1000 €) për organizatat e grave që nuk kanë qasje në burime të tjera të financimit dhe të cilat kërkojnë të punojnë për të drejtat e grave, veçanërisht në mesin e grupeve nga vendet rurale dhe/apo grupeve të marginalizuara. Në të njëjtën kohë, RrGGK është duke e përdorur këtë program grantesh që ti mentorojë anëtarët e saj në procesin e shkrimit të grantit, duke mbështetur kapacitetet e tyre për të aplikuar edhe për fonde nga donatorët e tjerë në të ardhmen.

Anëtarët e RrGGK-së kanë luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e fondit gjatë takimit në Prevallë dhe takimit tjetër përcjellës. Ato ndihmuan RrGGK-në të vendos për: llojet e financimit në dispozicion; shumat; afatet kohore; procedurat e aplikimit; si dhe për anëtarët e Komitetit Shqyrtues të Granteve të Fondit të Grave të Kosovës (të zgjedhur nga anëtarët e RrGGK-së). Bazuar në vendimet e aprovuara nga anëtarët dhe me ekspertizën e ofruar nga Fondi i Gruas për Rindërtim në Serbi, stafi RrGGK-së ka përgatitur format e aplikimit, procedurat e aplikimit, kriteret dhe termet e referencës për Komitetin Shqyrtues të Granteve, në tri gjuhë.

Të Arriturat e Fondit të Grave të Kosovës Grante të vogla, ndryshime të mëdha!

- Kapacitetet e anëtareve të RrGGK-së për të shkruar projekt propozime, janë rritur
- Anëtare të ndryshme të RrGGK-së, duke përfshirë grupet nga zonat rurale dhe minoritare, kanë qasje unike te fondet
- Zyrtarët komunal për Barazi Gjinore dhe institucionet tjera janë të përfshirë në nismat e anëtareve të RrGGK-së në disa komuna
- Anëtarët e RrGGK-së ofruan bashkë-financim të konsiderueshëm për nismat e tyre
- Kërkesa të mëdha për vazhdimin e Fondit të Grave të Kosovës



Të gjitha anëtares e RrGGK-së ishin të ftuara të marrin pjesë në seancat e informimit gjatë muajit tetor në Prishtinë (36 pjesëmarrëse), Gjakovë (22), Prizren (23) dhe Çagllavicë (20). Interesimi dhe pjesëmarrja e anëtareve ishte e madhe. Gjatë seancave, kordinatorja e RrGGK-së shpjegoi formën e aplikimit dhe procedurat përkatëse. Përveç kësaj, RrGGK organizoi katër seminare për të ngritur njohuritë e 36 anëtareve rreth planifikimit të buxhetit. Seancat përfshinin edhe një modul për parandalimin e korrupsionit. Punëtoritë mbështetën anëtares për të bërë projekte efektive. Stafi i RrGGK-së pastaj ofroi mentorim në vazhdimësi për të gjitha anëtares e interesuara (30 konsultime individuale). Ushtrimet mbuluan tema të cilat do të fuqizojnë anëtares në nisma të avokimit dhe për të mundësuar qasje në mundësitë potenciale të financimit nga donatorë të tjerë.

“RrGGK është shumë e suksesshme në ofrimin e shërbimeve për anëtares e saj. Puna e palodhshme e stafit të RrGGK vihet në dukje përmes mbështetjes që i ofrojnë OJQ-ve të vogla, në mënyrë që ato të ndihen të fuqizuara”.

-Anëtare e RrGGK-së

“U ndjeva e dobishme që isha pjesë e një nisme të madhe që ndryshoi jetën e grave nga zonat rurale.”

RrGGK ka pranuar 28 propozime, dhe Komiteti i Shqyrtimit të Granteve u takua më 15 tetor, duke përzgjedhur 12 propozime. Kontratat për grante janë nënshkruar me përfituesit më 20 tetor. Grantet u morën nga gratë më aftësi të ndryshme, grupe etnike (p.sh., Shqiptare, Serbe, Boshnjake, Gorane, Rome, Ashkali, Egjiptiane) si dhe nga rajone të ndryshme. Ndërkohë që nismat e anëtareve janë në vazhdim e sipër, deri tani ato kanë arritur disa rezultate:

- 1) Gratë për Gratë me aftësi të kufizuara nga Prizreni me projektin “E dua jetën ashtu siç jam” organizoi debate publike që përfshin gratë me aftësi të kufizuara (€960). Diskutimet u përqëndruan në nevojat dhe sfidat




shëndetësore. Morën pjesë gjithsej 45 femra me aftësi të kufizuara përreth zonave rurale, gjithashtu iu ofrua kontroll mjekësor në qendrat e shëndetit publik (p.sh., pap teste, teste të traktit urinar, si dhe mamogramet). Zyrtarja komunale për Barazi Gjinore si dhe Drejtorja për Shëndetin Publik në Prizren ka mbështetur nismën e këtij projekti. Shoqëria civile dhe koordinimi i autoriteteve lokale mund të jenë hapi i parë drejt përmirësimit të shëndetit të grave me aftësi të kufizuara si dhe për zhdukjen e barrierave për kujdesin shëndetësor për ato që kanë nevojë.

- 2) Dhjetë gra të verbëra të moshave të ndryshme kanë mësuar si të gatujnë përmes Organizatës së të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar gjatë një punëtorie katër javore mbi përgatitjen e ushqimit (€900). Si iniciativë e parë e kësaj organizate të re, projekti mbështeti gratë dhe vajzat e verbëra të bëhen të pavarura. Në të njëjtën kohë, gratë e verbëra të përfshira në këtë iniciativë krijuan miqësi dhe solidaritet.

**“Ju më dhatë shpresë për të jetuar.
Tani mund të përgatis qofte vet,
dhe do të befasojë familjen time
duke bërë drekën për ata.”**

- 3) “Ndal Dhunën” ka qenë tema e iniciativës *Lepsa Buducnost* në Prilluzhë (€700). Ato kanë organizuar tryeza të rumbullakëta dhe diskutime me 27 gra të moshave dhe etnive të ndryshme (Serbe, Boshnjake dhe Rome) se si duhet parandaluar dhunën në familje; mekanizmat e mbrojtjes, dhe ku mund të kërkojnë ndihmë nga autoritetet përkatëse. Fushata e tyre “Ndal Dhunën ndaj grave ka inicuar diskutime rreth respektimit të të drejtave të grave në komunitetet e tyre. Ato diskutuan gjithashtu se si të promovojnë të drejtat e grave në zonat rurale, veçanërisht në pjesët e banuara nga pakicat etnike.



Radosava Mirkovic
mban të veshur një
bluzë me moton
“Stop Dhunës”.



- 4) Shoqata e grave pensioniste VITA-JETA me projektin “mbrojtja e shëndetit të grave gjatë periudhës së tretë të jetës” (€860). VITA-JETA ka mundur për 260 paciente të bëjnë ekzaminimin e osteoporozës pa pagesë, drejt zbulimit të hershëm për gratë mes moshave 40 dhe 69. Ekzaminimi u shoqërua nga një ligjeratë mbi mënyrat se si të mbrohet shëndeti i njeriut si dhe mbi promovimin e qasjes të grave në shërbimet shëndetësore.

“Ditën fillova me shpresën se dikush do të kujdeset për shëndetin tim përveç familjes time.”

- 5) OJQ “ATO” organizoi një fushatë për edukimin shëndetësor të grave (€900), duke mbajtur pesë ligjerata mbi shëndetin riprodhues në pesë fshatra të komunës së Vushtrrisë. Në bashkëpunim me Departamentin e Shëndetit të Vushtrrisë, ato arritën tek 300 të rinj nëpërmjet diskutimeve në lidhje me shëndetin riprodhues, të drejtat riprodhuese dhe të shëndetit të grave, si dhe kujdesit me pacientë.
- 6) Shoqata Iniciativa e Grave ka organizuar një fushatë njëmuajore për të ngritur interesimin e informimin në lidhje me kancerin e gjirit në rajonin malor të Dragashit (€994). Pesëdhjetë gra Shqiptare, Serbe, Gorane nga zonat rurale mësuar se si të bëjnë vetë-ekzaminimin e kancerit të gjirit si dhe për rëndësinë e zbulimit të hershëm. “Ne kemi bërë shumë progres dhe kemi mësuar shumë”, tha një pjesëmarrëse. “Por na duhet kohë e gjatë për të mësuar dhe kemi nevojë për ndihmën Rrjetit”.



Gratë në Dragash bisedojnë me vizitoret nga RrGGK, si ta luftojnë kancerin e gjirit.

- 7) Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve është duke identifikuar të mbijetuarit e dhunës seksuale në Drenas (€620). Përmes grupeve mbështetëse institucionale dhe komunitare për gratë që kanë vuajtur dhunën seksuale gjatë konfliktit në Kosovë, të mbijetuarat kanë drejtuar tetë kërkesa Presidentes së Kosovës dhe autoriteteve

**“Të drejtat e mia janë të drejtat tuaja, duke
më respektuar mua si një viktimë e luftës, ne
mund të bëjmë shumë së bashku.”**

komunale, përfshirë edhe takimet me këta zyrtarë. Ato kërkuan që zyrtaret të respektojnë të drejtat e tyre dhe t'i fuqizojnë ato për tu marrë me sfidat që ato përballen në shoqëri.

- 8) Organizata e Personave me Distrofi Muskulare nga Prizreni i mbledhi 30 të rinjë me aftësi të kufizuara të etnive të ndryshme (Serbe, Shqiptare, Boshnjake dhe Turke) nga Prizreni, Ferizaji, Prishtina, Mitrovica, dhe Graçanica (€1,000). Përmes projektit “edhe ne kemi të drejta”, ata diskutuan sfidat me të cilat përballen dhe mënyrat se si të integrohen në jetën sociale dhe ekonomike. Pas diskutimeve, ata kanë marrë pjesë në aktivitete zbatimëse, duke shfaqur drama, shfaqje muzikore, dhe gara në shah. Aktivitetet fuqizuan të rinjtë me distrofi muskulare, përdërisa kjo iu mundësoi atyre edhe krijim të miqësisë mes vete.

- 9) Përmes organizatës Arta, 12 gra e vajza të moshave të ndryshme (17-70 vjeç) dhe etnive (Shqiptare dhe Turke) kanë qëndisur dy veshje tradicionale për tu shfaqur në zyrën e kryetarit të Komunes së Prishtinës

OJQ Arta, përfituese e grantit të Fondit të Grave të Kosovës përfshin gratë në krijimin e produkteve punëdore që do të shiten nëpër institucionet e Kosovës, duke i fuqizuar ekonomikisht gratë.



dhe në zyrën e Presidentes së Kosovës. Nisma ka promovuar shitjet me pakicë të veshjeve tradicionale, drejt fuqizimit ekonomik të grave. Në të njëjtën kohë ajo siguroi gratë pjesëmarrëse me fuqizimin ekonomik të përkohshëm.

“Jam 70 vjeçare. Nuk kisha mundësi për të qenë një grua e arsimuar, por duart e mia mund të qëndisin gjëra të bukura që të bëjnë jetën më të lehtë dhe më të bukur për mua.”

- 10) Gratë aktive të Gjakovës kanë mbajtur pesë trajnime mbi shëndetin riprodhues për 84 Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në fshatrat e Kolonia, Gjakovës, Skivjan, dhe Brekoc (€630). Organizata kryesisht ka punuar me vajzat e reja, pasi që numri i martesave të hershme duket se është rritur në këto fshatra. Ato thanë që njohuritë e ofruara rreth shëndetit riprodhues janë të rëndësishme për vajzat e reja.
- 11) Shoqata për Arsimim dhe Kujdes Familjar në Gjakovë organizoi katër seanca mbi “planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues” për 65 gra në tri fshatra: Sheremet, Rracaj, dhe Skivjan (€850). Shumica e grave shprehën mirënjohje pasi që këto ishin ligjëratat e para që ato kishin marrë pjesë mbi temën e planifikimit familjar.
- 12) Femra vizionare e shekullit XXI ka marrë €975 për projektin “Prezantimi i punës së OJQ-ve në mediat lokale.” Nëpërmjet pesë dokumentarëve, stacioni lokal televiziv prezantoi punën humanitare dhe nismat avokuese të organizatave lokale të drejtuara nga gratë, përfshirë Dora Dorës, Një në Një dhe të Shoqata e të Verbërve.



Gratë në Gjakovë flasin për shtatëzaninë dhe ëmësinë.



Gratë Vizonare ndihmojnë në tërheqjen e vëmendjes së publikut mbi punën e organizatave të grave në TV Opinion në Prizren.

Nëpërmjet këtij projekti ato gjithashtu kanë arritur tek gratë në zonat rurale dhe kanë mbajtur një tryezë të rumbullakët me 27 gra në ditën ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave.

RGK do të vazhdojë të ofrojë grante nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës në vitin 2013, duke u ngritur nga mësimet e nxjerra përmes kësaj përvoje. RGGK ka pranuar fonde nga Austrian Development Agency dhe KtK për të vazhduar Fondin e Grave të Kosovës gjatë vitit 2014.

Sfidat dhe Mësimet e Nxjerra nga Raundi i Parë i Fondit të Grave të Kosovës

- Grantet afat-shkurtër: nevojitet periudhë më e gjatë e grantit
- Grantet e vogla: kufijtë më të gjatë mundësojnë që organizatat përfituese të bëjnë më shumë
- Përfshirje më e madhe e autoriteteve komunale; praktikat më të mira tregojnë se ata mund të mbështesin OJQ-të
- Kërkohen trajnime të mëtejshme mbi shkrimin e projekt propozimeve, menaxhimin financiar, dhe në përdorimin e kompjuterëve
- Nxitja e nismave të përbashkëta midis anëtareve të RGGK-së
- Investim në dukshmërinë e aktiviteteve të organizatave përfituese

Më shumë vajza të reja aktiviste të përfshira në RrGGK

Këtë vit RrGGK ka hapur diskutimet mbi idenë, jo shpesh të dëguara dhe të folura, të përfshirjes më të madhe të vajzave të reja në vendim-marrje brenda lëvizjes së grave. Gjatë punëtorisë “Qëndrueshmëria për gratë aktiviste në Kosovë” në Durrës më 12-14 tetor, mbështetur nga KtK, 79 pjesëmarrëse (duke përfshirë 29 vajza të reja) u ndanë në grupe punuese për të diskutuar nevojën për të përfshirë më shumë vajza të reja në lëvizje, për ngritjen e aftësive tyre udhëheqëse, krijimin e kontakteve të reja dhe strategji për tranzicion. Kjo punëtori u përqëndrua si në mbajtjen e aktivizmit të aktivisteve ashtu dhe në përfshirjen e vajzave të reja në lëvizjet e grave. Tema kryesore ishte “Aktivizmi i qëndrueshëm: tejkalimi i boshllëkut të gjeneratave në lëvizjen e grave”. Nëpërmjet luajtjes së roleve anëtarët diskutuan se si të përfshijnë vajzat e reja në lëvizje; mobilizimin e aktivisteve të reja, ndërtimin e aftësive drejtuese; si dhe të zhvillohet demokracia e brendshme organizative. Në mbrëmje, RrGGK dhe



Në Durrës, anëtarët diskutojnë (edhe në gjuhën e shenjave) se si të përfshijnë më shumë vajza.

KtK organizoi aktivitete të ndryshme të kohës së lirë për aktivistet, përfshirë Yoga dhe një aheng, duke kontribuar në mirëqenien individuale të aktivisteve.

Më pas, RrGGK lancoi Iniciativën e Fuqizimit të Vajzave të Reja duke mbajtur dy takime fillestare me aktivistet e reja gjatë tetorit dhe nëntorit në Prizren (30 pjesëmarrëse) dhe Gjilan (10). Mbështetur fillimisht nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut



Vajzat identifikojnë prioritetet e tyre në një mbledhje të organizuar nga RrGGK në Gjilan.

**“Të nderuara gra të Rrjetit,
Kam dëshirë që të shpreh mirënjohjen
time të thellë për ju që më keni pranuar
në familjen e RrGGK-së. Udhëzimet e
juaja, këshillat dhe urtësia më
frymëzojnë çdo ditë për të ndjekur
rrugën tuaj.**

**Me nderime,
Blerina [Praktikante në RrGGK]”**

(YIHR), puna do të vazhdojë në 2013 me mbështetjen e KtK-së. Vajzat e reja diskutuan prioritetet dhe strategjitë për trajtimin e çështjeve me të cilat ato përballen. Ato besojnë se hapi i parë për të tejkaluar sfidat duhet të jetë ngritja e vetëdijes për të drejtat e grave në mesin e vajzave të reja, djemve dhe gjeneratave të vjetra. RrGGK inkurajoi ato që të vazhdojnë të mendojnë rreth ideve dhe mundësive për zgjidhjen e çështjeve të cilat ato përballen. RrGGK në vitin e ardhshëm do të ndihmojë ato që të identifikojnë aktivitetet konkrete për trajtimin e çështjeve të vajzave të reja. Udhëheqëset e kësaj iniciative janë aktiviste të reja të RrGGK-së.

Përveç kësaj, RrGGK ka përfshirë më shumë aktiviste të reja në punën e saj. Krahas përpjekjes për të siguruar që më shumë vajza të reja të marrin pjesë në mbledhjet e anëtareve të RrGGK-së, gjatë këtij viti në RrGGK janë punësuar dhe/apo janë përfshirë si praktikante 32 vajza të reja (shih listën me vullnetare dhe praktikante). RrGGK ofron trajnime në zyrë dhe mentorim për vajzat e reja, për ngritjen e kapaciteteve të tyre në fusha të ndryshme duke filluar nga teknikat kualitative të hulumtimit, aftësitë e shkrimit deri në menaxhimin e ciklit të projektit. Shumë prej vajzave të reja të përfshira në RrGGK kanë pasur pak ose aspak përvojë paraprake, një sfidë me të cilat përballen shumë të rinjë që kërkojnë për të hyrë në tregun e punës. RrGGK iu ka mundësuar atyre që të fitojnë përvojë vendimtare drejt sigurimit të vendeve të punës në të ardhmen në fushat e tyre të interesit.

**“Jam krenare që pata mundësinë
të punoja me ju! Vazhdoni kështu!”
Ish-praktikante e RrGGK-së**



Pa marrë parasysh nëse ato qëndrojnë me RrGGK-në apo të vazhdojnë në pozita të tjera, ato i marrin me vete këto njohuri edhe si një frymëzim për zhvillimin e barazisë gjinore kudo që jeta e tyre mund ti dërgojë.

Bashkëpunimi në mes të grave në rajon është rritur

Me mbështetjen e KtK-së, vajzat e reja aktiviste nga organizata të ndryshme anëtare të RrGGK-së, duke përfshirë edhe një anëtare të stafit RrGGK-së, kishin mundësinë për të shkëmbyer përvojat me vajzat tjera të reja në mbarë botën, të ndërtojnë aleanca, dhe të zhvillojnë më tej kapacitetet e tyre si udhëheqëse. Iniciativa filloi në vitin 2011 me një udhëtim studimor në Izrael dhe Palestinë, në të cilën morën pjesë një anëtare e stafit të RrGGK-së me katër kosovare tjera dhe pesë gra nga Serbia. Nisma vazhdoi me dy takime në vitin 2012. Së pari, gratë nga Serbia vizituan Kosovën në mars në një udhëtim të kordinuar nga një anëtare e stafit të RrGGK-së. Pastaj, gratë kosovare kanë vizituar homologet e tyre serbe në nëntor të këtij viti. Ato diskutuan për hulumtimin e përbashkët që do të nisin në vitin 2013 mbi nevojat e grave të reja si dhe do të organizohet një vizitë tjetër studimore në vitin 2013 për të ngritur kapacitetet e vetë grupit.

Ato gjithashtu kishin një punëtori në tetor me temën “Aktivizmi dhe Lidhshipi i Vajzave të Reja”. Vajzat e reja nga rajoni diskutuan dhe mësuan mbi udhëheqjen formale dhe joformale; rezistencën, që lidhet veçanërisht me generatat/udhëheqëset më të vjetra dhe mbi strategjitë për tejkalimin e sfidave. Miqësi të reja janë krijuar në mesin e të rejave nga Kosova dhe Serbia. Ato kanë në plan të vazhdojnë të mbështesin njëra-tjetrën dhe të bashkëpunojnë në aktivitete të përbashkëta.



Anëtarët tjerë të stafit të RrGGK-së vazhdojnë përfshirjen e tyre rajonale. Në vitin 2012, RrGGK ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat e grave në Shqipëri. Mes festimeve të shënuara në 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor, Shoqata Shqiptare “Në favor të Gruas Shqiptare”, OJQ “Refleksione” dhe “Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim” organizuan një sërë aktivitetesh me moton, “100 vjet të grave që kanë jetuar dhe kontribuar në Shqipëri”. Këto aktivitete gjithashtu shënuan 20 vjetorin e aktivizmit të grave në kontekstin e ndryshimeve politike në Shqipëri. Midis veprimtarive të tjera, ato organizuan një konferencë “90 + 20, lëvizja e grave në Shqipëri - rruga që duhet ndjekur”. Përveç historisë dhe kontributeve të grave në avancimin e shoqërisë shqiptare, në konferencë u diskutuan mësimet e mësuara dhe strategjitë për rrugën e mëtejshme. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së mbajti fjalimin mbyllës të konferencës, duke identifikuar parimet kryesore të nevojshme për të mbajtur të gjallë një lëvizje të grave:


1. **Diversitet:** Ne gratë jemi të ndryshme, por bashkohemi dhe bëhemi një për një qëllim. Nëse ne nuk pranojmë dallimet tona, atëherë nuk mund të ketë lëvizje;
2. **Solidaritet:** Pa marrë parasysh rrethanat, ne gratë duhet të bashkëpunojmë sepse ne luftojmë për çështje të përbashkëta. Ne duhet të shmangemi rasteve kur gratë sulmojnë gratë. Ne kemi nevojë për të mbështetur njëra tjetrën për të arritur qëllimet tona; dhe
3. **Aktivizëm:** Lëvizja nuk mund të jetë gjallë pa këtë element. Aktivizmi duhet të shprehet në rrugë, nëpërmjet deklaratave apo në mënyra të tjera. Që një lëvizje të mbahet e gjallë, ajo duhet të jetë e dukshme.

RrGGK ka planifikuar bashkëpunim të mundshëm në të ardhmen përtej kufijve drejt fuqizimit ekonomik të grave, me gratë nga Shqipëria, por që është në pritje të financimit.



Një çështje tjetër e rëndësishme për të cilën gratë kanë bashkëpunuar në nivel rajonal ka qenë për të kërkuar drejtësi lidhur me krimet e luftës, në veçanti dhunës seksuale, të kryera kundër grave gjatë vitit 1990 (shih seksionin tjetër).

Përtej rajonit, në prill morën pjesë tri përfaqësuese të RrGGK-së në “Forumit e 12-të Ndërkombëtar të AWID-it”. Kjo u dha një mundësi unike për të takuar dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme të grave në mbarë botën. Për anëtarin më të re të RrGGK-së, gjithashtu ka ofruar mundësi unike për të takuar organizata të ndryshme që tanimë kanë filluar aktivitetet me vajzat e reja. Anëtarët e RrGGK-së morën pjesë në programe për vajzat e reja dhe diskutime mbi ekonominë. Informatat e mbledhura do të inkorporohen në punën e ardhshme të RrGGK-së. Gjatë Forumit, RrGGK gjithashtu shpërndau librin e saj *1325 Fakte & Fabula*, duke shpërndarë 56 kopje aktivisteve të të drejtave të grave nga gjithë bota. Disa deklaruan se libri i frymëzoi ato që të përdorin Rezolutën ose të ndërmarrin përpjekje të ngjashme të monitorimit në vendet e tyre.



Në AWID, RrGGK iu bashkangjit mijëra personave në Stamboll, në marshin për të drejtat e grave.

RrGGK gjithashtu është përpjekur të mbështesë mundësitë për përfaqësueset e organizatave anëtare të RrGGK-së për të udhëtuar dhe të rrjetizohen në nivel rajonal. Mirëpo, për Kosovaret ka vështirësi për marrjen e vizave dhe kjo paraqet një sfidë vendimtare për të udhëtuar, si në rajon ashtu dhe në Evropë. Kjo pengon mundësinë e grave (dhe burrave) për të marrë pjesë në diskutime rajonale për Kosovën. Për shembull, RrGGK u përpoq të mbështesë anëtarët nga Organizata për Personat me Distrofi Muskulare për të udhëtuar në Slloveni, ku ato do të mund të rrjetizohen dhe të

mësojnë nga organizatat që punojnë për të njëjtën çështje. Megjithatë, atyre iu mohua viza kështu që ato e anuluan udhëtimin e tyre në çastin e fundit.

Në mënyrë të ngjashme, pesë gra kosovare u ftuan të marrin pjesë në një konferencë mbi dhunën seksuale, të organizuar në Sarajevë. Mirëpo, vetëm Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së kishte mundësi të merr pjesë sepse ajo kishte pasaportë shqiptare, ndërsa të gjitha pjesëmarrëseve tjera kosovare iu refuzuan vizat. Gjatë kësaj konference ajo iu prezantoi organizatave ndërkombëtare dhe lokale si dhe zyrtarëve nga gjyqësori në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi për përpjekjet e OSHC-ve dhe qeverisë për të ndihmuar gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës.

Pjesëmarrja e grave kosovare siguroi mbështetjen e themelimit të Gjykatës së Gruas

Diskutimet vazhduan edhe këtë vit rreth krijimit të një Gjykate të Gruas në lidhje me krimet e kryera në ish-Jugosllavi, edhe RrGGK ishte në mesin e kësaj nisme. Kjo nismë përfshinë udhëheqëset nga Kosova, Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, dhe Mali i Zi. Më 22 shtator, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së mori pjesë në një takim rajonal në Tivat, Mal të Zi, ku aktivistet në pozita udhëheqëse nga rajoni diskutuan proceset vendim-marrëse në të ardhmen në lidhje me Gjykatën e Gruas. Ato vendosën që Gratë në të Zeza në Serbi të drejtojnë punën teknike të Gjykatës së Gruas, të udhëhequr nga vendimet e nxjerra nga Komiteti Drejtues. Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së është anëtare e këtij Komiteti, dhe përfaqëson Kosovën.

Në nëntor, Gjykata e Gruas ftoi eksperte nga gjithë bota me ekspertizë si nga Gjykatat e Grave ashtu edhe në Evropën Juglindore për të diskutuar një qasje feministe në drejtësi në këtë rajon. Ato ofruan këshilla se si Gjykata e Gruas të mund të vazhdojë me punën e saj. Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi do të vazhdojnë të mbajnë trajnime rreth drejtësisë tranzicionale. Në Kosovë, RrGGK ka shfaqur për anëtarët e saj filmin



“Gjykata e Gruas: Një qasje feministe në drejtësi” prodhuar nga Gratë në të Zeza gjatë takimit të lartpërmendur të RrGGK-së, në Prevallë.

Përderisa Kosova është pjesë e nismës më të gjerë për të themeluar Gjykatën e Gruas, aktivistet vendosën që Kosova të ketë një qasje të pavarur, duke u përqëndruar në mbështetjen e grave të cilat kanë pësuar dhunë seksuale. Gratë që mbijetuan iu kanë thënë RrGGK-së dhe anëtareve të saj se ato nuk duan një gjykatë të veçantë (apo Gjykatë të Gruas), por kërkojnë drejtësi nëpërmjet institucioneve të rregullta. Prandaj RrGGK dhe anëtarët e saj do të vazhdojnë t'i mbështesin ato në arritjen e kësaj të drejte. Shumë nga organizatat anëtare të RrGGK-së vazhdojnë të punojnë në kuadër të komuniteteve të tyre për këtë çështje.

Pritjet e Mëttutjeshme: avancimi i kapaciteteve të RrGGK-së

Pasi që plani strategjik udhëzon punën tonë, është e nevojshme të identifikohen fushat ku ne kemi nevojë të punojmë më shumë në të ardhmen. Në vitin 2014, përveç vazhdimin të punës për të arritur rezultatet e sipërpërmendura, kemi në plan të bëjmë edhe përpjekje shtesë për të përmbushur aspektet e strategjisë tonë që ende nuk kanë përfunduar.

Grupet punuese të RrGGK-së krijojnë strategji për të ardhmen

Në vitin 2011, të gjitha grupet punuese të RrGGK-së krijuan një strategji që udhëzon punën e RrGGK-së si dhe punën e disa prej anëtareve të saj. Për shkak të kufizimeve kohore u kuptua që RrGGK nuk mund të organizojë aq shumë takime të grupit punues në vitin 2012 siç kishte shpresuar. RrGGK do të punojë më shumë në grupet punuese, veçanërisht në atë të shëndetësisë dhe fuqizimin ekonomik të grave, gjatë vitit 2013.



Rritja e Zbatimit të Kodit të Mirësjelljes në mesin e anëtareve

RrGGK ka vizituar 85 nga 100 anëtares e saj për të vlerësuar përparimin në zbatimin e Kodit të Mirësjelljes, Etikës dhe Përgjegjësisë të RrGGK-së, për të cilin të gjitha anëtares kanë rënë dakord ta përmbushin. Bazuar në intervista, RrGGK ka krijuar një dokument për secilën organizatë me informatat dhe nevojat e tyre; dhe është në proces të përditësimit të bazës së të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit ku përfshin nevojat e anëtareve. Anëtares e stafit të RrGGK-së po e përdorin këtë bazë të të dhënave së bashku me kërkesat e anëtareve të RrGGK-së për të krijuar një plan zhvillimi të kapaciteteve për anëtares e RrGGK-së. Kjo do të udhëzojë drejt mbështetjes së zhvillimit të

kapaciteteve ofroruar për anëtares e RrGGK-së, drejt zbatimit të Kodit të Sjelljes, si dhe avancimit të kapaciteteve të tyre institucionale në vitin 2013.



Anëtares dhe stafi i RrGGK-së diskutojnë objektivat e projekteve të tyre të stimuluar gjatë një ushtrimi grupor në Punëtorinë e RrGGK-së të Shkrimit të Projekt Propozimeve në Dhjetor.

“Nuk e bëjmë këtë në organizatën tonë. Është shumë mirë që të mësojmë se si të bëjmë më shumë.”

- Anëtare e RrGGK-së gjatë intervistës për Kodin e Mirësjelljes

RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE

Qëllimi afat-gjatë i këtij projekti është që “Gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe atë kombëtar.” Në vitin 2012, RrGGK ka arritur qëllimin afat-shkurtër për të rritur dhe për të përmirësuar pjesëmarrjen e gruas në politikë dhe në vendim-marrje në nivele komunale dhe kombëtare. Progres është shënuar përmes projektit “Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave kosovare në politikë dhe vendim-marrje” i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës. Më konkretisht, RrGGK ka arritur rezultatet e mëposhtme.

Themelohen tetë grupe avokuese funksionale për barazi gjinore

Grupet Avokuese për Barazi Gjinore organizojnë takime të grave në politikë dhe grave në shoqëri civile në



Igballe Rogova takohet me gratë nga shoqëria civile dhe gratë në politikë, duke inkurajuar bashkëpunim në zgjidhen e çështjeve me të cilat ballafaqohen gratë në komunat e tyre.

përpjekje për të luftuar për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në nivel komunal. Përderisa kemi planifikuar që të krijojmë pesë grupe të tilla, ne kemi mbështetur tashmë krijimin e tetë grupeve, ato janë në Novobërdë,

Dragash, Shtime, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë dhe Mamushë. Për më shumë, RrGGK është krenare që t'ju njoftoj se me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim, ne do të zgjerohemi me këtë nismë edhe në pesë komuna tjera gjatë vitit 2013.

“Ne nuk kemi pritur që ju do të pranoni që ne (si meshkuj) duam të Mbështesim barazinë gjinore.”

- Anëtar i Asamblesë Komunale, Gjilan

Përveç kësaj, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së ishte ftuar të flasë gjatë një mbledhjeje të Asamblesë Komunale në Gjilan. Ajo përmendi shembuj të burrave në Kosovë që luftojnë për barazi gjinore dhe e quajnë vehten feministë. Ajo poashtu sqaroi rëndësinë e mbështetjes së grave për njëra tjetrën dhe sigurimin e mbështetjes së burrave për çështjen e tyre. Shumë burra u ngritën dhe i thanë Drejtoreshës Ekzekutive të RrGGK-së që e pëlqyen fjalimin dhe interesimin e saj për përfshirjen e burrave në punë drejt barazisë gjinore.

Gratë në politikë, OJQ-të e grave dhe gratë votuese të komunikojnë, bashkëpunojnë me shumë rreth prioriteteve të grave

Solidariteti është krijuar dhe nxitur në mesin e grave nga sektore të ndryshme në nivelin komunal dhe në veçanti përmes GABGj-ve. Gjatë katër takimeve që përfshijnë përafërsisht 180 persona, GABGj-të diskutuan edhe për zgjedhjet, duke përfshirë se si ato mund të mbështesin gratë nga sektore të ndryshme në përgatitjen e tyre për t'u bërë udhëheqëse për të kandiduar në zgjedhjet e vitit 2014. Takimet shërbyen gjithashtu për të fuqizuar gratë në politikë në nivel lokal që të jenë zëri i votuesve të tyre dhe për të kandiduar në zgjedhjet e ardhshme.

“Më keni fuqizuar sepse deri tani jam ndërë shumë e vetmuar. Megjithatë, tani kur hapi ndonjë çështje për diskutim në punë, ndjehem sikur të gjitha gratë e përfshira në këto grupe [GEAGs] janë pas meje.
-Anëtare e asamablesë komunale



Nëpërmjet GABGj-ve, gratë politikanë dhe gratë në shoqërinë civile patën mundësi të bëjnë strategji për aktivitete të përbashkëta, ndonjëherë për herë të parë. GABGj-të iu kanë ofruar mbështetje grave në politikë nga gratë e tjera në politikë dhe nga shoqëria civile në kuadër të komunave të tyre, si dhe nga anëtarët e GABGj-së në komunat tjera.

Si rezultat i kësaj, femrat nuk ndihen vetëm kur përballen me diskriminime gjinore me vendimet e arritura brenda partive dhe/apo komunave të tyre. Në të njëjtën kohë, GABGj iu kanë ofruar grave në shoqërinë civile qasje më të lehtë për ta bërë zërin e tyre më të dëgjueshëm në kuvendet komunale duke iu mundësuar avokimin e tyre për

avancimin e të drejtave të grave në nivel lokal. Në përgjithësi GABGj-të kanë fuqizuar gratë në shoqërinë civile dhe politikë për t'u bërë udhëheqëse më të zëshme në komunat e tyre, si dhe për të mbështetur njëra tjetrën në përpjekje drejt avokimit në përparimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel komunal.

Përtej GABGj-së, shumë anëtare të cilat kanë marrë fonde nga RrGGK-ja nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës kanë bashkëpunuar me zyrtarë brenda komunave të tyre drejt avancimit të të drejtave të grave dhe barazisë gjinore.

*Anëtarja e
Asamblesë
Komunale të
Dragashit Luljeta
Berisha thekson
rëndësinë e kujdesit
për fëmijë për
fuqizimin ekonomik
të grave; dhe
inkurajon gratë që të
mbështesin
kandidatat femra.*



Më shumë femra të zgjedhura, të emëruara në nivelet komunale dhe qeveritare

Mirë, ne e pranojmë se kjo nuk është plotësisht brenda kontrollit tonë, poashtu edhe faktorë dhe aktorë të tjerë kanë qenë të përfshirë. Megjithatë, ne dëshirojmë të mendojmë se avokimi i pandërprerë i RrGGK-së për 13 vitet e fundit ka pasur të bëjë diçka me zhvendosjen e normave dhe qëndrimeve shoqërore, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për të emëruar më shumë gra në pozita vendim-marrëse. Nuk ka lëvizur shumë situata në këtë fushë gjatë vitit 2012 për shkak të kontekstit më të gjerë politik. Mirëpo, RrGGK-ja ka vazhduar punën për fuqizimin e grave udhëheqëse, sidomos në nivelin komunal. Në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme të vitit 2014, RrGGK ka filluar aktivitetin në nivel komunal, duke mbështetur më shumë gra për të hyrë në politikë dhe për tu bërë udhëheqëse më të forta.



Gratë parlamentare në vizitë me GABG-të nga Dragashi, Mamusha dhe Prizreni, duke shkëmbyer përvoja dhe duke formuar strategji për të çuar përpara të drejtat e grave.

Pjesëmarrje më të madhe të grave në proceset vendim-marrëse në lidhje me paqen dhe sigurinë, sipas Rezolutës 1325

Pas sa viteve të avokimit, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) më në fund ka marrë rolin udhëheqës në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit mbi Zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 (RKSKB 1325) në Kosovë. RrGGK-ja ka marrë pjesë në mënyrë aktive në grupin punues për hartimin e këtij plani, poashtu edhe ka shqyrtuar dhe ka ofruar rekomandimet gjatë hartimit të saj. Planifikohet të përfundojë në fillim të vitit 2013.



Më 22 tetor, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së morri pjesë në një konferencë që u organizua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Vjenë mbi zbatimin e Rezolutës 1325. Ajo në konferencë ju ofroj informata, në lidhje me përpjekjet drejt zbatimit të Rezolutës në Kosovë, OSBE-së si dhe organizatave tjera ndërkombëtare që punojnë në rajon.

Në Kosovë, RrGGK organizoi dy ngjarje që lidhen me pjesëmarrjen e gruas në vendim-marrje, sipas Rezolutës 1325. Së pari, më 8 mars, Dita Ndërkombëtare e Gruas, RrGGK ka vazhduar me traditën e saj të organizimit të protestës për të drejtat e grave. Këtë vit fokusi ishte në drejtësi për krimet e kryera kundër grave gjatë luftës, veçanërisht dhunës seksuale. Motoja e demonstratës ishte “Nuk duam lule, duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës.”

“Shoqet e mia, edhe pse nuk isha me ju fizikisht pasi që jam jashtë vendit, me mendje unë isha me ju në protestë. Ju uroj për punën që bëni për gratë dhe vajzat, jo vetëm për ato por edhe për gjithë shoqërinë.”

- Valdete Idrizi

Ngjarja e dytë kryesore, organizimi i një proteste, fushatë për shkrimin e një letre dhe peticioni, u mbajt në nëntor me moton “Drejtësi dhe Dinjitet para negociatave”. Rreth 1,000 njerëz morrën pjesë në protestë të organizuar nga RrGGK dhe Thirrjet e Nënave. Rreth 5,700 njerëz nga e gjithë bota kanë nënshkruar peticionin me kërkesat e njëjta si ato të bëra nga protestuesit: një kërkim falje nga Serbia për krimet e

**“Me nderime Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës,
Mbështesim përpjekjet dhe përkushtimet e juaja në kërkim të drejtësisë në emër të grave që mbijetuan dhunën në bazë gjinore në luftë. Në solidaritet dhe mbi lidhjen tone të afërt si motra,
Gratë nga Qendra për Studime të Grave në Zagreb
Rada Boric”**



kryera në Kosovë gjatë viteve 1990-ta, kthimi i personave të pagjetur, drejtësi për shkelje të të drejtave, si dhe kompensim për dëmet morale dhe ekonomike. Gjatë protestës paqësore, pjesëmarrësit ishin veshur kuq që simbolizon gjakun e viktimave të vrarë nga udhëheqja kriminale serbe gjatë genocidit 1998-1999 në Kosovë. Në fund të protestës, protestuesit vendosën një baner me kërkesat e tyre në pragun e ndërtesës së Qeverisë. RrGGK dhe Thirrjet e Nënave dërguan edhe letra që përmbajnë këto kërkesa te Sekretarja Amerikane e Shtetit Hillary Rodham Clinton, Kryesuesja e Politikës së Jashtme të BE-së Catherine Ashton, Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën Ulrike Lunacek, Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga, dhe kryeministri Hashim Thaçi.



Një qytetar nënshkruan peticionin për Drejtësi dhe Dinjitet para Negociatave.

“E dashura Igo dhe stafi i RrGGK, Që nga fillimi i punës suaj, keni punuar mirë, keni punuar shumë dhe keni qenë të suksesshme. Por sot, e gjithë puna juaj është shpërblyer. Qytetarët sot treguan mbështetje dhe simpati për ju dhe për këtë protestë, e cila ishte shumë e suksesshme dhe ka arritur qëllimin e saj. Ju dëshiroj sukses të mëtutjeshëm.

-Advije Gashi”



Qytetarët kërkojnë “Drejtësi dhe Dinjitet para Negociatave.”

Poashtu lidhur me zbatimin e Rezolutës 1325, RrGGK shpërndau librin e saj të ri *1325 Fakte & Fabula* duke iu dërguar vendim-marrësve kyç në Evropë dhe SHBA; duke e promovuar atë edhe në Forumin e Shoqatës së Grave në Zhvillim (AWID) në Stamboll; poashtu edhe duke e dërguar tek vendim-marrësit e Kosovës dhe tek anëtarët e grupit punues për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Kosovës mbi zbatimin e Rezolutës 1325; si dhe me shitjen e 13 kopjeve në Dit' e Nat (me kosto jo-fitimprurëse).

Gishtat tonë fluturonin nëpër tastierë gjatë vitit 2012!

RrGGK gjithashtu u përpoq të siguroj që zërat e grave të dëgohen në proceset e ndryshme të vendim-marrjes duke shkruar letra dhe komunikata për shtyp. Në vitin 2012, RrGGK shkroi 10 letra tek 87 zyrtarë të ndryshëm mbi çështjet me rëndësi për gratë (dhe burrat) në Kosovë:

- 1) Letër Xavier Bout de Marnhac në lidhje me hetimet e EULEX-it të rasteve të dhunimeve gjatë luftës (8 mars)
- 2) Letër Presidentes së Kosovës Atifete Jahjaga; Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Kosovës Hajredin Kuçi si dhe Zëvendëskryeminstres së Republikës së Kosovës për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë Kombëtare dhe Shefes së Delegacionit për dialogun teknik Kosovë-Serbi, Edita Tahiri, duke i informuar ata rreth protestës së organizuar nga RrGGK: “Nuk duam lule, duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës” (8 mars)

Përveç shkrimit të letrave, RrGGK gjithashtu mori një letër nga sekretarja amerikane e Shtetit, Hillary Rodham Clinton më 22 mars, duke falënderuar RrGGK-në për librin tonë *1325 Fakte & Fabula*, mbi zbatimin e Rezolutës së OKB-së 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë.



- 3) Letër Zëvendëskryeminstres Edita Tahiri duke shprehur pakënaqësinë me keqpërdorimin e parave të taksapaguesve në Ditën Ndërkombëtare të Gruas (15 mars)
- 4) Letër Ministrit të Financave të Republikës së Kosovës, Bedri Hamza dhe kryeministri Hashim Thaçi, duke shprehur pakënaqësinë me keqpërdorimin e parave të taksapaguesve në Ditën Ndërkombëtare të Gruas (15 mars)
- 5) Letër Presidentes Atifete Jahjaga dhe Zëvendëskryeminstrit dhe Ministrit të Drejtësisë Hajredin Kuçi, duke kërkuar zbatimin e Drejtësisë Tranzicionale (si në konferencën: “Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin - Çfarë mekanizmash janë të nevojshme për ndjekjen e së vërtetës në Kosovë”) (21 maj).
- 6) Letër Kryetares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Personat e Pagjetur, Suzana Novobërdaliu, lidhur me peticionin për dhënien e një statusi dhe të drejta për gratë viktime të luftës si dhe për dëshmorët e luftës, invalidët, veteranët, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimat civile dhe familjet e tyre (29 mars)
- 7) Letër për Catherine Ashton, Përfaqësuese e Lartë e BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë si dhe Zëvendës-Presidente e Komisionit Evropian, duke kërkuar ndërhyrjen e saj të fuqishme tek autoritetet serbe për të siguruar lirin, nga burgu arbitrar, të Hasan Abazit, kryetar i sindikatës së metalpunuesve të Kosovës dhe një ish-aktivist në rezistencën civile të Kosovës gjatë regjimit të Millosheviçit (prill)
- 8) Letër Zëvendëskryeminstrit dhe Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Kosovës, Hajredin Kuçi, duke kërkuar një takim për të diskutuar kontributin e mundshëm të RrGGK-së në raportin e progresit të Kosovës të Komisionit Evropian (20 tetor)
- 9) Letër për 20 përfitueset mbi zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, e shoqëruar me librin e RrGGK-së *1325 Fakte & Fabula* (31 tetor)

“Jam e magjepsur; libri [1325 Fakte & Fabula] është i mahnitshëm. Kam filluar ta lexojë që në mëngjes dhe nuk mund të ndalem. Dua të urojë të gjitha ato që kanë punuar në këtë libër. Një libër i mrekullueshëm.”



- 10) Letër Qeverisë dhe Kuvendit duke shprehur pakënaqësinë e grave dhe vajzave me Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 (19 nëntor)

Për më tepër, RrGGK ka dërguar 14 kumtesa për media në vitin 2012:

- 1) RrGGK mbështet protestën “Kundër ligjit për qendrën historike në Prizren” (26 janar)
- 2) Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës: Diskriminimi Gjinnor në Kosovë (2 shkurt)
- 3) RrGGK shpreh ngushllimet për popullin e Restelicës dhe falënderon Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) për reagimin e tyre të suksesshëm (13 shkurt)
- 4) RrGGK reagon mbi mënyrën e paraqitjes së femrave në media (27 shkurt)
- 5) Nuk duam lule: Më 8 mars Gratë kërkuar për Drejtësi për femrat e dhunuara gjatë luftës (3 mars)
- 6) RrGGK organizoi protestë “Nuk duam lule, duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës” (8 mars)
- 7) RrGGK reagoi mbi keqpërdorimin e parave të taksapaguesëve nga Edita Tahiri për Ditën Ndërkombëtare të Gruas (15 mars)
- 8) RrGGK shpreh ngushëllimet për studentët të cilët vdiqën në Himarë dhe të mbijetuarve ju dëshiron shërim të shpejtë (22 maj)
- 9) RrGGK nis me Fondin e Grave të Kosovës (25 tetor)
- 10) Gratë dhe vajzat janë të pakënaqura me Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 (19 nëntor)



Qindra gra dhe burra të mbledhur më 8 Mars në protestën e RrGGK-së duke kërkuar drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës.

- 11) Drejtësi dhe Dinjtet para Negociatave (1 nëntor)
- 12) Protestë “Drejtësi dhe Dinjtet para Negociatave” e organizuar nga RrGGK dhe *Thirrjet e Nënave* dhe JO nga *Vetëvendosja* (2 nëntor)
- 13) Fillon peticioni “Drejtësi dhe Dinjtet para Negociatave” (5 nëntor)
- 14) Rreth 5,700 qytetarë nënshkruan peticionin për të kërkuar “Drejtësi dhe Dinjtet para Negociatave “ (26 nëntor)

RrGGK shqyrtoi një numër të aktiviteteve konkrete që rezultojnë nga letrat e saj dhe kumtesat për media. Për shembull, pas letrave për të kërkuar drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës, ka pasur një stuhi diskutimesh mbi këtë temë (e diskutuar shumë rrallë në Kosovë gjatë këtyre 12 viteve të fundit). Organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe donatorët kanë organizuar diskutime për këtë çështje dhe ka pasur një përpjekje të rinovuar për të mbështetur personat që vuajtën dhunën seksuale gjatë luftës.



Gra dhe burra marshojnë duke kërkuar drejtësi dhe dinjtet para negociatave.

Politikat publike u ndryshuan për të pasqyruar prioritetet e votueseve gra

RrGGK është krenare për të raportuar se përpjekjet tona të avokimit kanë rezultuar në disa ndryshime të rëndësishme politike. Këtu, ne gjerësisht definojmë politikat për të përfshirë ndërrime në veprimet e zyrtarëve të qeverisë. Në fillim të vitit 2012, Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së u takua me Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë rreth tri kërkesave: që qeveria të caktojë Kryeshefin/en Ekzekutiv/e të Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGj), ku një zyrtare e ngarkuar me punë ka qenë aty për vite me rradhë, të marrin masa publike për të mbrojtur të drejtat e



lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transeksualëve (LGBT), si dhe për të kryesuar përpjekjet mbi zbatimin e Rezolutës 1325. Pas këtij takimi, të tre kërkesat u plotësuan. Së pari, qeveria pothuajse menjëherë punësoj Kryeshfene Ekzekutive të ABGj-së. Së dyti, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Çështjet Gjinore, ka filluar një grup konsultativ që përfshin kryesuesit e grupeve LGBT për të diskutuar se si qeveria mund të mbështesë përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Së treti, ABGj hartoi një Plan Kombëtar të Veprimtimit për Zbatimin e Rezolutës 1325.

Pas avokimit të RrGGK-së më 8 mars për të tërhequr vëmendjen e qeverisë ndaj nevojave të grave që mbijetuan dhunën seksuale të kryer gjatë luftës, të nesërmen grupi i grave parlamentare e ngriti këtë çështje në Kuvendin e Kosovës. Përveç kësaj, Ministria e Integritimit Europian Vlora Çitaku ftoi RrGGK-në për të diskutuar se çfarë mund të bëjë ajo në këtë drejtim. Ministria Çitaku ka formuar një Grup Punues qeveritar mbi dhunën seksuale ndaj grave.



Pas avokimit të RrGGK-së më 8 Mars për të tërhequr vëmendjen për gratë që mbijetuan luftën, zyrtarët filluan punën për këtë çështje.

Dejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së poashtu ka shtyrë çështjen dhe ka pasur sukses mbi sigurimin e një paneli mbi dhunën seksuale ndaj grave që të përfshihet në agjendën e Samitit Ndërkombëtar të Gruas më 4-6 tetor, të organizuar nga Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga me mysafirë të shquar, përfshirë Madeleine Albright. Një ndër rekomandimet që rezultoi në këtë konferencë ishte: “Konfirmojmë se proceset dhe insitucionet e konfliktit, post-konfliktit dhe drejtësisë tranzicionale janë të çështje të ndjeshme gjinore dhe që duhet të pranojnë statusin ligjor të viktimave të dhunimit, që publikisht të njohin madhësinë e përjetimeve të tyre, të kompensojnë ato për lëndimet e tyre dhe ti ndjekin penalisht autorët e krimit.”



RrGGK gjithashtu mbështeti ndryshimet e politikave në nivel komunal. Në komunën malore të Dragashit, ku nuk kishte sistem të transportit publik më herët gjatë këtij viti. Gra udhëheqëse në komunë kanë identifikuar këtë si një çështje thelbësore që ndikon në mundësinë e grave për të udhëtuar në Prizren, qytetin më të afërt, për punësim, arsim dhe kujdes shëndetësor. Grupin Avokues për Barazi Gjinore i mbështetur nga RrGGK u takua me Kryetarin e Komunës së Dragashit për të shpjeguar çështjen. Pothuajse menjëherë, ai siguroi instalimin e transportit të rregullt publik për regjionin. Tani gratë mund të udhëtojnë më lirshëm.

Duke punuar drejt pjesëmarrjes së gruas në vendim-marrje

Ne kemi shumë punë përpara nesh drejt realizimit afatgjatë të qëllimit tonë që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe atë kombëtar. Në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme, RrGGK ka plane që në vitin 2013 të ndërmarrë përpjekje shtesë për të forcuar kapacitetet e grave udhëheqëse në veçanti të atyre në nivel komunal; duke përmirësuar komunikimin ndërmjet grave politikane dhe grave votuese, si dhe të mbështes gratë votuese në identifikimin e prioriteteve të tyre, drejt informimit të platformave të partive politike për zgjedhjet 2014. Këto përpjekje do të marrin mbështetje nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

“Ne nuk ndihemi më sikur jemi vetëm anëtare të një partie politike. Ne ndjejmë se jemi pjesë e një grupi të tërë që avokon për gratë.”

- Anëtare femër e Asamblesë Komunale

Në vitin 2012, RrGGK filloi punën drejt qëllimit strategjik që “Buxheti i Kosovës të reflektojë më shumë prioritetet e avokuara nga gratë.” RrGGK ka hulumtuar dhe publikuar një raport mbi shpenzimet e shtetit për dhunën në familje, i financuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Iniciativa e Sigurisë dhe Sigurimit të Grave. Avokimi në vazhdim përfshiu vizita tek Kordinatorja Kombëtare e sapoemëruar për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje dhe një dokument faktesh në lidhje me buxhetimin për dhunën në familje u shpërnda në të gjithë ministrinë. Pas shqyrtimit të parë të buxhetit në Kuvendin e Kosovës, RrGGK gjithashtu shkroi një letër për të gjithë parlamentarët duke avokuar për rishikimin e buxhetit, drejt zhvillimit njerëzor, në vend të shpenzimeve në infrastrukturë (shpenzim kryesor). Përderisa Kosova ka ende për të shqyrtuar ndryshimet në buxhet, RrGGK do të vazhdojë të avokojë për një buxhet që reflekton më mirë prioritetet e shumicës së grave (dhe të burrave).



PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESIN CILËSOR SHËNDETËSOR

Për qëllimin e tretë afat-gjatë, RrGGK ka për qëllim që “gratë të kenë qasje në kujdes cilësor shëndetësor dhe që të jetë një qasje e përballeshme”. Qëllimi kryesor afatshkurtër është të përmirësojë qasjen e grave në kujdes cilësor shëndetësor.

Pasi që oraret kohore ishin të zëna kjo do të thotë se puna më e madhe drejt këtij qëllimi strategjik është shtyrë për vitin 2013. Kështu që, duke ju falenderuar punës së madhe të anëtareve të RrGGK-së, ka pasur përparim drejt arritjes së këtyre rezultateve të pritshme.

Më shumë gra dhe vajza të vetëdijshme për të drejtat e tyre dhe rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

Grantet e ofruara nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës mbështetën shumë përpjekje për të avancuar njohuritë e grave dhe vajzave në qasje në kujdesin shëndetësor. Anëtarët e mëposhtme të RrGGK-së kanë marrë grante për të punuar drejt këtij rezultati:

- Gratë Aktive nga Gjakova mbajtën ligjëratë mbi shëndetin riprodhues të grave nga komunitetet RAE

“Edhe pse dikur kam qenë motër medicinale, kurrë nuk e kam vërejtur se vuaja nga osteoporozja. Vetëm përmes VITA-JETA e mora iniciativën që të bëj testin që e diagnostifikoi atë.”

- Përfituese nga OJQ VITA-JETA



- Shoqata e Grave Pensioniste “VITA JETA” njoftoi gratë mbi edukimin shëndetësor të grave të moshave të shtyra, në veçanti përmes ekzaminimit të osteoporozes
- Qendra e Grave “ATO” mbajti ligjëratë mbi edukimin shëndetësor për grupe të grave
- Shoqata për Nismat e Grave promovoi edukimin e vet-kontrollimit për kancerin e gjirit
- Shoqata për Edukim dhe Kujdes Familjar punoi mbi shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar në komunitetet RAE.

Më shumë gra të vetëdijsuara se si të zbulojnë shenjat e kancerit

Në vitin 2012, ne vumë re kulminacionin e punës që është bërë me vite për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore që kanë të bëjnë me kancer. Pas protestave, avokimeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme të anëtares së përkushtuar të RrGGK-së, Qendra Kosovare për Luftën kundër Kancerit të Gjirit “Jeta / Vita”, institucionet shëndetësore dhe klinikat private i dhanë vëmendje të konsiderueshme kancerit të gjirit gjatë Muajit Ndërkombëtar kundër Kancerit të Gjirit. Grupi i Grave parlamentare mori pjesë në ngritjen e vetëdijes, duke përfshirë vendosjen e një posterit në ndërtesë të parlamentit.

Për një muaj, dy klinika private ofruan mamograme falas për të ekzaminuar kancerin e gjirit (Spitali Amerikan dhe Aloka). Për shkak të kërkesës së lartë, ata pastaj e zgjatën nismën edhe për një muaj.



Gratë marshojnë në protestën “Ecje për shërim” që të ngrisin vetëdijësimin për kancerin e gjirit.



RrGGK gjithashtu mbështeti organizaten Jeta / Vita, në organizimin e fushatës së tyre vjetore “Ecje për shërim” më 5 tetor në Prishtinë. Morën pjesë edhe mysafirë të shquar si Ulrike Lunacek, anëtare e Parlamentit Evropian dhe Raportuese për Kosovën si dhe ambasadorë të ndryshëm në Kosovë. Qindra qytetarë morrën pjesë në këtë ngjarje në solidaritet me gratë që mbijetuan kancerin e gjirit.

Ecja kishte qëllim ngritjen e vetëdijes në mesin e grave dhe shoqërisë rreth kancerit të gjirit, i cili besohet të jetë në rritje në Kosovë, sepse kushtet për zbulimin e hershëm dhe trajtimin janë të kufizuara. Në të njëjtën ditë ato nisën një peticion të iniciuar nga Qendra e Grave Prehja në Skenderaj; peticioni kërkon që pajisjet e rrezatimit që qëndrojnë në bodrumin e Institutit onkologjik të përdoren. Anëtarët e RrGGK-së mbledhen nënshkrime brenda komuniteteve të tyre. Dukshëm, hapi i ardhshëm do të jetë përmirësimi i *cilësisë së kujdesit* të jetë në dispozicion për trajtimin e kancerit në Kosovë.

Qasja në kujdesin cilësor shëndetësor: një rrugë e gjatë përpara

RrGGK pranon që mbetet shumë punë për të bërë drejt përmirësimin të qasjes së grave në kujdes cilësor shëndetësor në vitin 2013. RrGGK ka aplikuar për fonde për të kryer hulumtime mbi qasjen e grave ndaj kujdesit cilësor shëndetësor, në mënyrë që të dal me rekomandime më specifike të politikave në këtë drejtim. Pastaj, duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, RrGGK do të ketë sistemin shëndetësor si një pikë qendrore të përpjekjeve të avokimit.



Qytetarët mbledhen për të marshuar kundër kancerit të gjirit.

NJË JETË E LIRË NGA DHUNA NË FAMILJE DHE TRAFIKIMI

Përpjekjet për të siguruar se “gratë jetojnë një jetë të lirë nga dhuna në familje dhe trafikimi”, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2012. RrGGK ka si qëllim specifik strategjik për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit kundër trafikimit dhe dhunës në familje dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me legjislacionin dhe se si të kërkohet ndihmë. RrGGK ka bërë progres drejt këtyre të dy qëllimeve.

Rritja e zbatimit të Ligjit dhe Strategjisë për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje

Raporti i fundit i monitorimit të RrGGK-së sugjeron se ka pasur progres, edhe pse i kufizuar, drejt zbatimit të Ligjit dhe Strategjisë për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Është e qartë se progresi nuk ka qenë tërësisht nën kontrollin e RrGGK-së, pasi që veprimet nga institucionet ishin poashtu të nevojshme. Megjithatë, RrGGK mendon se monitorimi dhe avokimi i qëndrueshëm për këtë çështje për 12 vitet e fundit ka kontribuar në progresin e arritur.

Arritja më e madhe këtë vit në kuadër të programit të RrGGK-së për të adresuar dhunën në familje dhe trafikimin, në tetor, u botua në *Me Çfarë Çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, pas gati një vit hulumtimi intensiv. Financuar nga Mbretëria e Holandës përmes programit Iniciativa për Sigurinë e Gruas të UNDP-së, hulumtimi shqyrtoj shpenzimet e dhunës në familje nga shteti. Me përdorimin e një qasje të përgjegjshme gjinore të buxhetit ajo gjithashtu vështroj përgjegjshmërinë gjinore ndaj buxhetit të Kosovës si tërësi. Raporti identifikoi mangësitë dhe strategjitë për të përmirësuar proceset dhe alokimet buxhetore në drejtim të zbatimit të



kornizës ligjore për mbrojtjen kundër dhunës në familje. RrGGK ka vizituar institucione të ndryshme, duke avokuar për zbatimin e rekomandimeve të bëra në kuadër të politikave të këtij raporti.

Një arritje tjetër në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) ka qenë hartimi dhe përfundimi i përafërt i një kurrikule me udhëzime për punëtorët shëndetësor në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, trajtimin dhe referimin. Kurrikula synon të rrisë ndërgjegjësimin në mesin e punëtorëve shëndetësorë drejt adresimit të dhunës në baza gjinore, duke përfshirë, kur rastet e dhunës potenciale janë identifikuar gjatë ekzaminimeve shëndetësore. Nëse Ministria e Shëndetësisë adopton këtë program dhe fillon zbatimin e tij, e cila pritet që të bëhet në vitin 2013, atëherë RrGGK në bashkëpunim me UNFPA dhe Ministrinë e Shëndetësisë do të fillojnë zbatimin e aktivitetit të paraparë në Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe sipas Plani të Veprimit për 2011-2014.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me legjislacionin, duke përfshirë edhe burrat

RrGGK në bashkëpunim me UNFPA organizuan tri sesione informuese mbi kornizën ligjore lidhur me dhunën në familje për rreth 90 përfaqësues të organizatave jo-qeveritare në tri komuna të caktuara nga ekipi i programit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për të adresuar dhunën me bazë gjinore: Gjakovë, Gjilan dhe Dragash. Punëtoritë informuan organizatat vendore jo-qeveritare në lidhje me ligjet ekzistuese dhe mekanizmat për adresimin e dhunës në baza gjinore.

RrGGK gjithashtu mbështeti një prej organizatave anëtare të saj, *Lepsa Buducnost*, për të bërë aktivitete në rritjen e ndërgjegjësimin në vendin me shumicë serbe të Prilluzhës, përmes Fondit të Grave të Kosovës të RrGGK-së. Përveç kësaj, me mbështetje nga KtK, RrGGK-ja mbështeti Dora Dorës që të ndërmarrë një fushatë për 15 Ditët kundër Dhunës ndaj Grave që përfshinte aksione në rrugë, distribuimin e fjongove dhe broshurave nga vullnetarët;



këngëtaren Rona Nishliu me këngën e saj të re kundër dhunës; debate të të rinjëve në Prishtinë dhe Prizren; një garë të shkrimit të eseve në Gjakovë; debate televizive; vizatime për fëmijë; një deklaratë kundër dhunës ndaj grave; dhe mbulim të gjërë mediatik. Këto aktivitete prekën rreth 200,000 njerëz me përkujtimin se dhuna vazhdon të shfaqet dhe se të gjithë kanë përgjegjësi për ta ndaluar atë. Fushata u zhvillua pothuajse tërësisht në përpjekje vullnetare.

Përveç kësaj, RrGGK ka mbështetur një përpjekje të veçantë nga Royal Productions për të nisur një seri televizive me titull “Duke kërkuar të Drejtat e Grave”. Seria përfshin rastet reale të dhunës në familje, të cilat shikuesit i ndjekin përmes procesit të kërkimit të drejtësisë. Seria synon të fuqizojë gratë të përdorin mekanizmat ligjore dhe për të ngritur vetëdijen rreth mekanizmave të cilat duhet të përdoren dhe se si të përdoren ato. Çdo program përfundon pozitivisht me zgjidhje të çështjeve të cilat ballafaqohen në realizimin e drejtësisë. Dy episode të serisë së planifikuar dy-vjeçare kanë marrë mbështetje nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës përmes RrGGK. Royal Productions është duke kërkuar fonde për episodet e ardhshme. RrGGK poashtu në mënyrë aktive morri pjesë në një numër aktivitete gjatë 15 Ditëve kundër Dhunës ndaj Grave.



Të rinjtë marrin pjesë në një aksion në rrugë kundër dhunës në familje në Prizren, si pjesë e fushatës së Dora Does të mbështetur nga RrGGK kundër dhunës ndaj femrave.



AVANSIMI I FUQIZIMIT EKONOMIK TË GRAVE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të kenë qasje të barabartë në mundësitë e punësimit në Kosovë. Qëllimet afatshkurtra janë për përmirësimin e pozitës ekonomike të grave në Kosovë dhe për të përmirësuar qasjen e grave në pronë (dhe kështu në atë kapitale), në përputhje me të drejtat e tyre ligjore. Grupi Punues për fuqizimin ekonomik të grave ka identifikuar fuqizimin e bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe sigurimin e kapitalit për gratë, si fushat më të rëndësishme të ndërhyrjes për RrGGK-në.

Forcohet grupi punues brenda RrGGK-së, themelohet strategjia

Për shkak të kufizimeve kohore dhe aktiviteteve të tjera, RrGGK nuk ka qenë në gjendje të organizoj takime të rregullta me Grupin Punues për Fuqizimin Ekonomik të RrGGK-së këtë vit. Mirëpo, RrGGK ka marrë disa hapa për të ndërtuar kapacitetin e brendshëm të stafit saj për përparimin e fuqizimit ekonomik të grave. Siç u përmend, anëtarët e stafit të RrGGK-së morën pjesë në Forumin e AWID-it në Stamboll. Përveç mësimit të strategjive të ndryshme të avokimit në lidhje me fuqizimin ekonomik të grave, RrGGK ka luajtur një rol aktiv në diskutimet mbi përgjegjshmërinë e donatorëve dhe përdorimin efikas të burimeve për organizimet rreth të drejtave të grave gjatë Forumit.



Me mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës, anëtarë të OJQ Arta krijojnë produkte tradicionale punëdore për t'i shfaqur në zyret e qeverisë.

Kërkojmë dhe presim: fuqizim ekonomik të grave

Fatkeqësisht burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare përjashtuan RrGGK-në për të ndërmarrë shumë përpjekje në këtë drejtim gjatë vitit 2012. Përderisa RrGGK ka aplikuar për dy projekte të lidhura me fuqizimin ekonomik të grave, asnjëra nuk është miratuar.

Në vitin e ardhshëm, RrGGK do të kërkojë për të adresuar rezultatet e pritura të planit strategjik që më shumë gra të jenë të afta për të zhvilluar dhe për të menaxhuar bizneset me sukses, më shumë qytetarë janë në dijeni për të drejtat e grave në trashëgimi dhe në pronë, dhe se më shumë gra kërkojnë për të siguruar të drejtën e tyre për trashëgimi dhe pronë. RrGGK gjithashtu ka identifikuar disa strategji drejt avansimit të fuqizimit ekonomik të grave në të cilën ne do të fokusohemi në vitin 2013.

Për informata më të përditësuara, ju lutemi vizitoni ueb faqen tonë: www.womensnetwork.org.



Prodhimi i punimeve tradicionale punëdore iu ofron grave të ardhura për familjet e tyre. Duke kontribuar në të ardhurat e familjeve të tyre, gratë mund të fitojnë një zë më të fortë në vendim-marrje.



PËR MË TEPËR...

Fillimi i iniciativës së rrëfimeve gojore

Gjatë verës, RrGGK në bashkëpunim të ngushtë me Universitetin New School në Nju Jork filloi një nismë të re për të dokumentuar historitë jetësore të grave të ndryshme në Kosovë. Janë bërë tri intervista me gratë aktiviste dhe intervista tjera do të bëhen në të ardhmen. Iniciativa gjithashtu përfshin dokumentimin e jetës së grave që morën pjesë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) duke i mbështetur ato për të prodhuar një libër rreth jetës së tyre para, gjatë përfshirjes së tyre në UÇK. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të kuptuar rolin e grave që kanë luajtur në luftën e viteve 1998-1999 për shkak të mungesës së njohjes publike për këtë grup të veçantë, dhe më pas për shkak të mungesës së dukshmërisë me ndërtimin e vendit pas pavarësisë. Intervistat filluan në gusht dhe do të vazhdojnë deri sa të gjitha gratë që dëshirojnë të marrin pjesë të intervistohen. Deri më sot gjashtë gra kanë rrëfyer historitë e tyre.

Iniciativa Historia Gojore ka marrë mbështetje nga Universiteti New School, veçanërisht Dr Anna Di Lellio, kandidate për PhD, Virginia Stephens nga Universiteti Goldsmiths; Kaltrina Krasniqi, regjisore, dhe shumë gra të tjera aktiviste, studiuese dhe përkthyesë të cilat ofruan kohën e tyre në mënyrë vullnetare për këtë nismë të rëndësishme (shih listën e vullnetareve më poshtë).



Në mesin e grave të intervistuar për Iniciativën e Historisë Gojore është aktivistja dhe aktorja Safete Rogova e cila ka ndihmuar në edukimin e mijëra femrave që nga vitet e hershme të 1990-ta.

Mbulimi mediatik dhe aktivizmi në internet

RrGGK kishte të paktën 78 raste të mbulimit mediatik në vitin 2012, duke përfshirë edhe televizionin, shtypin, dhe online. RrGGK ka ridizajnuar, përditësuar dhe në mënyrë të konsiderueshme ka zgjeruar ueb faqen e vet (www.womensnetwork.org). Ueb faqja e re është më interaktive, përmban më shumë informata mbi historinë e RrGGK-së që nuk ishin postuar asnjëherë më parë në uebfaqen paraprake, dhe përmban fusha të reja për Fondin e Grave të Kosovës dhe anëtarët e RrGGK-së (që mund të identifikohen në bazë të komunës dhe fushës së ekspertizës), me informata për secilen ngjarje, menjëherë posa ajo të ketë ndodhur. Në vitin 2012, RrGGK ka përdorur ueb faqen e saj, faqen e Facebook-ut (<http://www.facebook.com/pages/Kosova-Womens-Network/128138803913145?fref=ts>) dhe grupin e Facebook-ut për të:

- Shpërndarë buletin tonë mujor “Zëri i Gruas Kosovare” në të tri gjuhët.
- Shpërndarë informatat për thirrjet për aplikim për Fondin e Grave të Kosovës.
- Shpërndarë informatat lidhur me bursat e studimeve të ofruara për shkallën Master.
- Promovuar peticionin për “Drejtësi dhe Dinjitet para Negociatave”.
- Organizuar protestë për “Drejtësi dhe Dinjitet para Negociatave”.
- Organizuar protestë në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, më 8 Mars, për drejtësi për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës.
- Reaguar për veprimet e Zëvendës Kryeministres Edita Tahiri sa i përket keqpërdorimit të parave të taksapaguesve në Ditën Ndërkombëtare të Gruas.
- Përkujtuar gratë të cilat kanë humbur jetën si viktime të dhunës në familje.
- Ftuar anëtarët që të marrin pjesë në shfaqjen e filmit dokumentarë “Tre Minuta të Heshtjes” nga Visar Krusha për Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë.




- Shpërndarë thirrjen për aplikim për praktikë dhe pozita të ndryshme të punës të hapura nga RrGGK.
- Promovuar aktivitetet e RrGGK-së në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare (p.sh. AWID).

RrGGK kishte 12,281 vizitorë të ueb faqes (krahasuar me 12,000 në vitin 2012). Prej këtyre vizitave 7,529 ishin vizitorë unik. Në kuptimin e ndërveprimit me ueb faqen e RrGGK (“të klikuarit përreth”), ishin 920,428 klikime, krahasuar me 907,783 klikime në 2011.

Anëtarësimi në Grupin e Facebook-ut të RrGGK-së (http://www.facebook.com/home.php?sk=group_205489469489614) u rrit nga 66 anëtarë në vitin 2011 në 94 anëtarë në vitin 2012. Grafiku i mëposhtëm ilustron numrin e njerëzve që “flasin për” RrGGK-në në Facebook.¹ Grafiku ilustron faktin që përpjekjet e RrGGK-së për të rritur dukshmërinë e vet dhe për të përfshirë më shumë njerëz në përpjekjet e veta avokuese kanë pasur sukses, veçanërisht lidhur me fushatat avokuese. Grafiku ilustron qartë rritje dinamike të përdorimit në Mars 2012, që korrespondon me organizimin e protestës “Nuk duam lule, Duam Drejtësi për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës” nga RrGGK më 8 Mars.

Përdorimi i Faqës së RrGGK në Facebook, gjatë vitit 2012



¹ “Duke folur për” sipas Facebook-ut, përfshinë “numrin e njerëzve që ndajnë stori për faqen tuaj”. Këto stori ofrshijnë plqimet e Faqes tuaj, postimet në linjën kohore të Faqes tuaj, pëlqimi, komentimi apo shpërndarja e ndonjërit prej postimeve të Faqes tuaj përgjigja në një pyetje që keni postuar, konfirmimi i pjesëmarrjes për ndonjërin nga ngjarjet tuaja, përmendja e Faqes tuaj, “tagging” e Faqes tuaj në ndonjë foto, “check in” në lokacionin tuaj (Përdoruesit unik).”



VLERËSIMI I PUNËS SË RRGGK

Stafi RrGGK ka përgatitur raporte semestrare dhe raporte financiare që janë shqyrtuar dhe miratuar nga Bordi i RrGGK. Anëtarët e RrGGK kanë vlerësuar punën e RrGGK gojarisht gjatë takimeve të rregullta dhe me shkrim gjatë takimit Vjetor të Anëtareve të RrGGK. Vlerësimi vjetor për RrGGK-në dhe punën e saj, bëhet çdo vit në fund të vitit. Ai përfshinë një pyetësor në lidhje me sukseset e rrjetit, mangësitë dhe rekomandimet për përmirësim. Pyetësi është shpërndarë tek anëtarët e rrjetit dhe palët tjera gjatë takimit vjetor. Vlerësimet janë anonime.

“Rrjeti është shumë i afërt me anëtarët e veta, veçanërisht në kohërat kur ato kanë nevojë.”
- Anëtare e RrGGK

Në përgjithësi, anëtarët e kanë vlerësuar punën e RrGGK shumë pozitivisht. Anëtarët i shohin takimet e RrGGK-së si “Shumë të dobishme” dhe “shumë të rëndësishme” për suksesin e RrGGK-së dhe organizatave të tyre. Përmes takimeve ato thanë se informohen për çështjet aktuale; diskutojnë dhe debatojnë çështje të lidhura me fuqizimin e grave në Kosovë dhe jashtë saj; dhe informojnë anëtarët e tjera për aktivitetet e tyre. Takimet e RrGGK poashtu ofruan mundësi për të mësuar për thirrjet për aplikime dhe për të marrë pjesë në iniciativa tjera avokuese rreth të drejtave të grave. Ambienti miqësorë i krijuar në takime është shumë i rëndësishëm, shkruan një anëtare, pasi që takimet krijojnë hapësirë që anëtarët të ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyra të ndryshme. “Takimet kanë qenë shumë të vlefshme pasi që na kanë ndihmuar të identifikojmë gratë që kanë qenë të dhunuara gjatë luftës,” shkruan një anëtare tjetër. Kjo ka ndihmuar anëtarët që të organizojnë më mirë ndihmën për gratë e prekura nga lufta, drejt ndërtimit të paqes në veçanti në një nivel individual.

“RrGGK avokon në emër të organizatave tona dhe na ndihmon me shërbime teknike dhe përkthim. Ajo është si një urë lidhëse për ne.”
- Anëtare e RrGGK



Vlerësimi poashtu sugjeroi që anëtarët e RrGGK gjithashtu e shohin buletin elektronik të RrGGK-së “Zëri i Grave Kosovare” si të dobishëm dhe çmojnë intensifikimin e ndarjes së informatave nga RrGGK në Facebook. “Ne jemi anëtare të reja në RrGGK, dhe komunikimi me RrGGK-në përmes rrjeteve sociale është më se i mjaftueshëm,” shkruan një anëtare. “Pranimi i informatave të ndryshme përmes e-mailit është gjithmonë shumë i rëndësishëm sepse ne jemi shumë afër me rrjetin pa marrë parasyh ku jemi,” shkruan një tjetër anëtare.

Anëtarët kërkuar që stafi RrGGK-së të vizitojë më shumë punën e tyre. Përdërisa RrGGK është duke kërkuar për të përmirësuar në këtë dimension, me 100 anëtare është sfiduese për të vizituar të gjitha ato rregullisht. Megjithatë, punësimi i dy anëtarëve të stafit shtesë për 2013 shpresojmë se do të ndihmojë RrGGK-në të arrijë më shumë anëtarët e saj. RrGGK po planifikon veprimtari të tjera të cilat do të përfshijnë anëtarët e saj.

Disa anëtare kërkuar që RrGGK të vendosë më shumë informata në ueb faqen e RrGGK pasi që është mënyra më e besueshme për të mbetur të informuar për çështjet aktuale të lidhura me gratë dhe punën e tyre si aktiviste. RrGGK ka riorganizuar ueb faqen e vet, duke e përmbushur këtë kërkesë. Anëtarët e RrGGK poashtu kërkuar që RrGGK të vazhdojë të punojë lidhur me fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave; të asistojë me krijimin e rrjeteve lokale dhe regjinale të OJQ-ve të grave; të punojë më shumë me viktimat e luftës; të vazhdojë me punëtoritë e shkrimit të projekt propozimeve; dhe të vazhdojë të shpërndajë informata lidhur me mundësitë e financimeve për anëtarët e saj.



Anëtarët vlerësojnë punën e RrGGK-së në vitin 2012.

MBËSHTETËSIT E RRJETIT DHE MBËSHTETJA PËR ANËTARET

Mbështetësit tanë

Në vitin 2012, RrGGK ka pranuar mbështetje financiare nga:

- Kvinna till Kvinna
- Ambasada e Mbretërisë së Holandës
- Iniciativa e Sigurimit dhe Sigurisë së grave, UNDP
- Fondacioni Mott
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA)
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR)
- Universiteti New School

Falënderojmë bizneset e mëposhtme, të cilat na ofruan mallra dhe shërbime pa pagesë, ose me normat të zbritura, duke mbështetur punën tonë:

- Night Design
- Hotel Gorenje
- Hotel Prishtina
- Hotel Sirius
- Hotel Dolce Vita
- Hotel Sharr



Raporti financiar i RrGGK-së për vitin 2012

Donatori	Projekti	Të bartura nga viti 2011	Të pranuar në vitin 2012	Të shpenzuara/ Shpenzimet	Të mbetura që të barten në vitin 2013
Kvinna till Kvinna Suedi	Fuqizimi i kapacitetit të RrGGK për Avokim	€ 6,855.73	€ 74,790.00	€ 49,351.00	€ 25,439.00
Kvinna till Kvinna Suedi	Kontratë për Organizimin e Dy Takimeve të Rrjetit		€ 20,500.00	€ 20,500.00	€ 0.00
Kvinna till Kvinna Suedi	Mbështetja e Organizatave të Grave në Kosovë; Krijimi i Fondit të Grave		€ 29,993.00	€ 28,993.00	€ 1,000.00
UNDP	Hulumtim mbi koston e dhunës në familje për shtetin	€ 9,981.74	€ 18,500.00	€ 28,481.74	€ 0.00
Ambasada e Mbretërisë së Hollandës	Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave Kosovare në Politikë dhe Vendim-marrje Demokratike	€ 46,496.51		€ 44,186.51	€ 2,310.00
UNFPA	Ngritja e vetëdijësimit për mekanizmin e barazisë gjinore në Kosovë në sektorin e shëndetësisë		€ 14,147.59	€ 10,327.59	€ 3,820.00



Universiteti New School	Mbështetje për “Historinë Gojore”		€ 1,850.00	€ 1,850.00	€ 0.00
Fondacioni Mott	Mbështetje e përgjithshme 2012-2013		€ 19,413.00	€ 19,413.00	€ 0.00
YIHR	Iniciativa e të rinjëve, projekt me vajzat		€ 2,116.04	€ 2,116.04	€ 0.00
Ambasada e Mbretërisë së Hollandës	Duke Kërkuar të Drejtat e Grave (TV seritë e Royal Productions mbi zgjidhjet indtucionale për dhunën në familje)		€ 8,208.10	€ 8,208.10	€ 0.00
Austrian Development Agency	Duke mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave		€ 140,400.00	€ 0.00	€ 140,400.00
Total		€63,333.98	€329,917.73	€213,426.98	€172,969.00

Deri më 30 Nëntor, shpenzimet operative të RrGGK-së përbënin 25.83% të shpenzimeve. Kjo për arsye se shumë nga shpenzimet tona operative në fakt kontribuojnë në përpjekjet tona programatike. Për shembull, përdërisa anëtarët e stafit janë “shpenzim operativ” puna e tyre është programatike: ato udhëheqin rrjetëzimin e RrGGK-së, avokimin, komunikimin dhe punën për të ndërtuar kapacitetet e anëtareve tona.



INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To: EXECUTIVE MANAGEMENT OF KOSOVO WOMENS NETWORK (K.W.N)
PRISHTINA

We have audited the costs and supplementary financial data of Kosovo Women's Network (K.W.N) expresses in EUR, for period ended December 31, 2012. We expressed an unmodified audit opinion on those financial statements in our report dated February 23, 2013.

Management's Responsibility for the Summary Financial Statements

These financial statements and supplementary financial data are the responsibility of the project's management.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on the aforementioned financial information based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISA). Those standards require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the reporting forms are free of material misstatement. An audit includes examining, on a test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the reporting forms. An audit also includes assessing the accounting principles used and significant estimates made by management, as well as evaluating the

Opinion

In our opinion, the summary financial statements derived from the audited financial statements for period ended December 31, 2012 are a fair summary of those financial statements in accordance with the International Standards on Auditing (ISA) issued by the International Federation of Accountants (IFAC).

Xhemal Sylla
Statutory auditor
"Syle Hoda"91
Prishtine
Republic of Kosovo
Phone: ++377 44 156 921
Central Fax: +381 38 551 790

Prishtina,

23 February 2013



XHEMAL SYLLA
Statutory Auditor
094/156 921, Prishtina

Duke i Mbështetur anëtarët: Grantet e Fondit të Grave të Kosovës

Në vitin 2012, RrGGK ofroj 12 grante për organizatat anëtare të saj përmes Fondit të Grave të Kosovës .

#	Organizata	Shuma	Emri i projektit
1	Gratë për Gratë më aftësi të kufizuara	€960	E dua jetën time si jam unë
2	Gratë Aktive nga Gjakova	€630	Ligjërime mbi shëndetin riprodhues për gratë e komuniteteve RAE
3	E Ardhmja e Nditur (<i>Lepsa Buducnost</i>)	€700	Ndalo dhunën
4	Femra vizionare e shekullit XXI	€975	OJQ-të e grave nga Prizreni prezantuan punën e tyre
5	Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamur të Dobësuar	€900	Të mësojmë si të përgatisim ushqim
6	Shoqata e Grave Pensioniste “VITA JETA”	€860	Edukimi shëndetësor dhe rendësia e saj për gratë gjatë periudhës së tretë të jetës së tyre
7	“ARTA”	€820	Fuqizimi i grave
8	Qenrda e grave “ATO”	€900	Ligjërime mbi edukimin shëndetësor për grupet e grave
9	Shoqata për nismat e grave	€994	Kanceri i gjirit merr jetë
10	Shoqata për edukim dhe kujdes familjar	€850	Shëndeti riprodhues: Planifikim familjar në mes të komuniteteve RAE
11	Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve	€620	Identifikimi i rasteve të personave të abuzuar seksualisht gjatë luftës në rajonin e Drenasit
12	Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës	€1,000	Edhe ne kemi të drejta
	Gjithsej	€10,209	



Donacionet për anëtarët e RrGGK-së

RrGGK ka vënë një rekord të ri për gjërat e dhuruara te organizatat e saj anëtare gjatë këtij viti, veçanërisht në saje të Fondit për Zhvillim Komunitar (CDF) dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), e cila dhuroi kompjutera për anëtarët RrGGK-së. Anëtarët e mëposhtme të RrGGK-së kanë pranuar donacione nga RrGGK-ja në vitin 2012:

- Prehja nga Skenderaji: një kompjuter
- Organizata e Personave me Distrofi Muskulare, Prizren: €200 për një ngjarje që shënon Javën e Personave me Distrofi Muskulare. Ato mbajtën një ngjarje në qendër të Prizrenit. Pastaj, pasi që ëndrra e personave që vuajnë nga distrofia muskulare në zonë ishte për të vizituar kështjellën në kodër të Prizrenit, atyre iu ofrua ndihmë nga KFOR-i për të shtyrë karrocet e pjesëmarrësve në majë të malit. Kjo ngjarje iu lejoj atyre për të realizuar ëndrrën e tyre si dhe për të ngritur vetëdijen në lidhje me këtë gjendje të veçantë shëndetësore, poashtu edhe për çështje që njerëzit e tillë përballen me qasje në hapësira publike.
- Qendra për të ardhme të sigurt, Pejë: tavolinë pune dhe raft për libra
- Rrjeti i organizatave Rome, Ashkali, dhe Egjiptiane në Kosovë, Prishtinë: Një tavolinë për takime për 10 persona, 4 karrige, dhe karrige që hapen, dhe një tavolinë që hapet.
- Alma, Pejë: një printer
- Femra Vizionare e Shekullit XXI, Prizren: një kompjuter
- ATO Vushtrri: një kompjuter
- Iniciativa e Grave, Dragash: një kompjuter
- Jeta Ime, Gjakovë: një kompjuter
- Lira, Prishtinë: një kompjuter

Në takimin vjetor të RrGGK-së, anëtarët morën një kompjuter, një kompjuter portativ me një çantë, një MP3, dhe surpriza të tjera. Gjithsej, RrGGK ka ofruar një shumë prej **€1,500** që ka dhënë në mallra për anëtarët e saj. Gjithsej, RrGGK këtë vit ka ofruar rreth **€11,909** për anëtarët e saj.



PËR NE

Bordi i drejtoreve të RrGGK-së

Elmaze Gashi, Kryesuese e Bordit; Drejtoreshë Ekzekutive, Alter Habitus
Elita Gota, Aktiviste
Besim M. Kajtazi, Drejtor i zyrës ligjore, Qeveria e Kosovës
Sevdie Bunjaku, Drejtoreshë Ekzekutive, Kalabria
Shukrije Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive, Partnerët e Kosovës Prishtinë
Sevdie Ahmeti, Aktiviste për të Drejtat e Njeriut
Dr. Minire Bunjaku Zuna, gjinekologe, aktiviste për të Drejtat e Njeriut

Anëtarët e stafit të RrGGK-së në 2012

Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive
Nicole Farnsworth, Menaxhere Programi & Drejtuese e Hulumtimeve
Besa Shehu, Menaxhere Financiare & Administrative
Zana Rudi, Kordinatore e Projektit për Anëtarët
Albertina Binaku, Kordinatore e Projektit për Fondin e Grave të Kosovës (shtator – dhjetor)
Alba Loxha, Kordinatore për Marrëdhënie me Publikun (janar – shtator)
Nertila Qarri, Kordinatore për Marrëdhënie me Publikun (nëntor – dhjetor)
Sadije Lalloshi, Kordinatore e Projektit mbi GBV (shkurt – dhjetor)
Blerina Kaçiku, Praktikante (gusht – dhjetor)

Bordi këshilldhënës i RrGGK-së

Delina Fico
Marte Prenkpalaj
Rachel Wareham
Vjosa Dobruna
Behar Selimi

**Stafi i RrGGK-së është
i mrekullueshëm. Ato
na njoftojnë për çdo
gjë në një mënyrë
shumë transparente
dhe korrekte.
- Anëtare e RrGGK-së**



Stafi kohë-shkurtër dhe ekspertet

Elizabeth Villagómez Morales, Eksperte në buxhetim të pëgjegjshëm gjinor

Ariana Qosaj-Mustafa, eksperte ligjore

Milva Ekonomi, Ekonomiste

Ada Shima, Hulumtuese

Dua Dauti, Hulumtuese

Nazlie Bala, Eksperte në kornizen ligjore mbi dhunën në familje

Praktikantet e RrGGK-së dhe vullnetaret

Jemi tepër mirënjohëse për më shumë se 29 persona të cilët kontribuan me kohë dhe energji, duke mbështetur punën e RrGGK-së këtë vit.

Ofruan ndihmë të rëndësishme që e bëri punën e RrGGK-së të jetë më e vlefshme!

Ada Shima

Alba Loxha

Amy Hillock

Anna Di Lellio

Arianna Federici

Arlinda Stublla

Athina Doutis

Blerina Kaqiku

Brikena Avdyli

Crisitina Mari

Dafina Beqiri

Donjeta Murati

Dua Dauti

Fjolla Dukagjini Klisurica

Fjolla Vukshinaj

Franziska Güther

Genta Haxhija

Itziar Muji

Kaltrina Krasniqi

Liridona Doberdolani

Lura Limani

Mimoza Paquku

Paula Astorga

Rachel Cleary

Rina Krasniqi

Sara Nicole Baxley

Shqipe Gjocaj

Stephanie Chaban

Virginia Stephens



Ekipi i hulumtimit të RrGGK-së për Buxhetimin Gjinor diskutojnë metodologjinë e hulumtimit të tyre.

Gjithashtu falënderojmë anëtarët tona, Bordin e Drejtoreshave dhe Komitetin Shqyrtues të Granteve, për punën e tyre vullnetare!

Anëtarët e RrGGK-së

Jemi krenare që Rrjeti është rritur me 15 organizata anëtare të reja në vitin 2012. Si rezultat, ne kemi arritur numrin 100 anëtare!

“Puna e suksesshme e Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës, bën që numri i anëtareve të rritet çdo vit.”
- Anëtare e RrGGK-së

Nr.	Organizata	Adresa e zyrës	Emri Mbiemri
1	Alma	Rr. Shpëtim Bojku, Nr.1, Pejë	Shemsije Seferi
2	Alter Habitus	Prishtinë	Eli Gashi
3	Antigona	Rr. Fehmi Lladrovci, H/II Nr. 6, Skenderaj	Rabe Rrustemi
4	ATO	Rr. Wesli Clark Pn, Vushtrri	Fikrije Ferizi
5	Aureola	Kompleksi Avalla, B/I, Nr.4, Prishtinë	Sanije Grajçevci
6	Arta	Veterniku I, Prishtinë	Hafije Qyqalla
7	Artpolis	Rr. Shaban Polluzha, P.n., Prishtinë	Zana Hoxha Krasniqi
8	Bardha	Rr. Shaip Spahia 45 A, Prishtinë	Raza Sadrija
9	Bliri	Drenas	Mahije Smajli
10	Dera e Hapur	Rr. Tringë Smajli, Nr. 72, Prishtinë	Belgjzare Muharremi
11	Diana	Rr. Musa Zajmi 142, Gjakovë	Silvana Vokshi
12	Dora Dorës	Rr. Mbreti Zog 59, Prizren	Vjosa Curri
13	Dora e Ngrohtë	Rahovec	Drita Rama



14	Diakonie Kosova	Rr. Bislim Bajgora, P.n. 40.000 Mitrovicë	Blerina Muriqi
15	Down Syndrome Kosova	Kroi i Bardhë, Nr. 72, Dardania, Prishtinë	Leonora Shabani
16	Duart e Dardanës (DeD)	Luigj Gurakuqi 39, Gjakovë	Fatime Ahmeti
17	EMINA - Grupi i Grave Boshnjake	7 Shtatori, Jakup Ferri, Mitrovicë	Fata Zatriqi
18	Familja dhe Shpresa	Klinë	Atifete Bytyqi
19	FANA	Rr. Zhuj Selmani, Nr. 103, Pejë	Fane Gashi
20	Foleja	Zahir Pajaziti, Nr. 9, Zyrja Nr. 5, Prizren	Gjyzel Shaljani
21	Femrat Aktive të Gjakovës	Rr. Sulejman Vokshi, Nr. 1, Gjakovë	Valbona Doli Rizvanolli
22	Femra Vizionare e Shekullit XXI	Fsh. Bregdrini, Has, Prizren	Marte Prekpalaj
23	Forumi Demokratik i Gruas (FDG)	Rr. Mbretëresha Teuta, Nr. 103, Pejë	Myzafere Ibishaga
24	Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim (F.E.ZH.)	Bregu i Diellit Zona e Lindjes, Ll. 12, Nr. 7	Vjollca Zeqiri
25	Fatjona	Rr. Malishevë, Banjë	Fatime Limaj
26	Fortesa	Kamenicë	Sanije Jahiri
27	HANDIKOS, Femrat me aftësi të kufizuar	Dardania B1/5, Prishtinë	Mehreme Llumnica
28	Hanëmeli	Bajram Kelmendi 46/3, Prishtinë	Lirije Gashi
29	Idemo Pravo	Plemetinë	Zhivadinka Radosavlevic
30	Istituti Psikologjik - Psikoanalitik (IPP)	Rr. Arkitektëve Karl Gega, Nr.4, Prishtinë	Anduena Arni



31	Iniciative për Bujqësi dhe Zhvillim të Kosovës (IADK)	Rr. Ulqinit, Nr. 74, 40 000 Mitrovicë	Magbule Hyseni
32	Iniciativa 6 - Nëngrupi i Grave "OAZA"	Jusuf Gërvalla Pn, Tregu i Gjelbërt II /a, Prizren	Osman Osmani
33	IKEBANA	Gotovushë, Shtërpcë	Ankica Stancic
34	JETA	Skenderbeu, Pallati i Kulturës, Kati i I, Deçan	Safete Gacaferri
35	Jeta Ime	Permet Vula 25, Gjakovë	Shqipe Bejtullahu
36	Jeto Jetën	Vajzat e Sulit Pn, Prizren	Xhynaze Bytyqi
37	Kalabria	Ish Emshiri, Prishtinë	Sevdie Bunjaku
38	Komitet Zena za Zastitu i Ljudska Prava – Caglavica	Caglavica	Snezana Karadzic Merima Dubova
39	Komiteti i Grave të Verbëra, SHVPDK	Bregu i Diellit, Rr. Gazmend Zajmi, Ndërtesa e Standardeve, Prishtinë	Bajramshahe Jetullahu
40	Kosovo Mental Disability Rights Initiative (KMDRI)	Rr. Nëna Terezë, 30C/1, Nr. 2, Prishtinë	Zamira Hyseni Mjellma Luma
41	Klubi i Basketit me Karroca (KBK) "Marsi"	Rr. Zahir Pajaziti Pn, Prizren	Drita Vukshinaj Valbona Bytyqi
42	Kelmendi	Fshati Kelmend - Lipë	Valbona Kelmendi
43	Legjenda	Viti	Melihate Osmani
44	Lepsa Buducnost	Zel. Kolonija, Prilluzhje	Radosava Mirkovic
45	Lidhja e Gjallë e Kosovës	Ismail Raka, Kaçanik	Kadrije Berisha



46	LIRA	Prishtinë	Valire Buza
47	Lulebora	Mentor Retkoceri, Nr. 9b, Prishtinë	Selvete Gashi
48	Lulishtja	P. F. Keqekollë, Dabishevc	Sadije Dulahu
49	LUNA	Prilluzhje	Stanica Kovacevic
50	LIVCK	Fushëkosovë	Elhame Strumcaku
51	LIVCK	Drenas	Mustaf Prenku
52	Medica Kosova	Luigj Gurakuqi 39, Gjakovë	Veprorre Shehu
53	Mundësia	Rr. Vëllezërit Dragaj, Nr. 4, Mitrovicë	Hasime Tahiri
54	Mentor Tolaj – NDERI	Deçan	Ganimete Tolaj
55	MEDIKA BL	Kalabria	Bukurije Leti
56	Shoqata e Grave të Mitrovicës për të drejtat e njeriut	Kodëra e Minorëve, Mitrovicë	Vetone Veliu
57	Ne Jemi Pjesë e Botës	Rr. Lidhja e Pejës Pn, Pejë	Gjylfidane Morina
58	NORMA	Rr. Afrim Vitija, Nr. 3/1, Prishtinë	Valbona Salihu
59	Next Alternative	Dragash	Shqipe Muç olli
60	Organizata e Gruas se Pavarur Kosovare (OGPK)	Magjistralja Fushë Kosovë - Prishtinë	Rudina Gerdeci Llaspashtica
61	Një në Një Kosova	Rr. Caraleva, Nr. 36, Prizren / Rr. 17 Nëntori 65, Pejë	Merita Halitaj
62	Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK)	Rr. Zahir Pajaziti Pn, Prizren	Resmija Rahmani

63	Organizata e të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar – ndërkomunale	Rrg. Hysen Rexhepi, p.n., Prizren	Miradije Buqaj
64	Organizata e Gruas “Barazia”	Rr. Brigada 123, Pn, Suharekë	Sevdije Sadiku
65	OJQ SHIPPL	Rr. Mbretëresha Teutë, Pn, Pejë	Ardiana Gorani
66	Prehja	Rr. 28 Nëntori, Pn, Skenderaj	Ajnishahe Halimi
67	Qendra e Gruas “Liria”	Rr. 28 Nëntori, Pn, Gjilan	Nazife Jonuzi
68	Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit JETA/VITA	Tringë Smajli, Prishtinë	Nafije Latifi
69	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)	Bedri Shala 53 A, Bregu i Diellit 2, Prishtinë	Feride Rushiti Sebahate Pacolli
70	Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)	Rrustem Statovci Nr.28, Prishtinë	Luljeta Vuniqi
71	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF)	Ulpiana Rr. Imzot Nikë Prela, Nr. 45, Prishtinë	Naime Sherifi
72	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT)	Pashko Vasa I IA, Prishtinë	Hamijet Dedolli
73	Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG)	Xhevat Begolli 9, Pejë	Ardita Bala

74	Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve – Prizren	Asaf Haxhi Vebiu 36, Prizren	Jubilea Kabashi Nora Hoxha
75	Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore (QTSGJ)	Luan Haradinaj 9/4, Prishtinë	Diamant Binaku
76	Qendra për Ardhmëri të Sigurtë (QATS)	Pejë	Ajshen Kastrati
77	Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës (RROGRAEK)	Nëna Terezë 18/1, Prishtinë	Shpresa Agushi
78	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Femijeve	Qendra Tregtare, Kati I 3, Nr 42, Drenas	Kadire Tahiraj
79	RONA	Rr. Ilaz Agushi, Prishtinë	Serbeze Sylejmani
80	Ruka + Ruci	Fushë Kosovë/Ugljare	Nevenka Rikallo
81	RIKOTTA	Rr. Adem Gllavica, Nr. 143	Pranvera Bullaku
82	Shoqata e Grave GORA	Rr. Haxhi Zeka, Nr. 20, Prishtinë	Sevdija Ramadani
83	Shoqata e Gruas INDIRA	Videjë / Klinë	Tone Gjergjaj
84	Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes	Nënë Tereza 181, Gjakovë	Bahrije Deva
85	Shoqata e Grave Femere “Krusha e Vogël”	Krusha e Vogël, Bregdrini, Prizren	Dile Prekpalaj

86	Shoqata e Grave Drita e Krushës (ShGDK)	Dardania SU 4/4, FS, Krushë e Madhe	Ola Syla
87	Shoqata e Grave të Veja "KRUSHA"	Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit	Fahrije Hoti
88	Shoqata Iniciativa e Grave	Dragash	Gjejrane Lokaj
89	Shoqata e Femrave me Aftësi të Kufizuara "Femrat për Femra"	Rr. Zahir Pajaziti Pn, Prizren	Drita Vukshinaj
90	Shoqata e Grave "Medica Gjakova"	Rr. Fadil Nimani, Nr. 34, Gjakovë	Zejnete Dylatahu
91	Shoqata e të Shurdhërve në Prizren	Rr. Tregu i Gjelbërt, Nr. 8/A, Prizren	Krenare Hajredini
92	Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA	Qemajli, Nr.9, Qarshia e Jupave, Gjakovë	Mirlinda Kusari Purrini
93	Shoqata e grave "Begatia"	Fshati Klinë e Epërme, Komuna e Skenderajit	Hyra Tahiri
94	Shpresë & Shtëpi për fëmijët	Taslixhe, Prishtinë	Valbona Çitaku
95	Shtëpia e sigurt	Gjergj Fishta PN, Gjakovë	Sakibe Doli - Dobruna
96	Top Radio	Sadik Pozhegu, Gjakovë	Violeta Dema
97	Venera	Shpëtim Bojku, Nr. 1, Pejë	Miradije Gashi
98	Violete	Barilevë, Prishtinë	Bedrije Shala
99	Vita – Jeta	"Lidhja e Prizrenit" Pn, Prishtinë	Ajshe Nuhiu
100	Zana	Klinë	Tahire Gashi



